



MINISTRI I MBROJTJES PIRRO VENUGU: TASHMË INDUSTRIA USHTARAKE DREJT PRODHIMIT TË ARMËVE SHQIPTARE



» faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI MORI PJESË NË FORUMIN E MBROJTJES DHE STRATEGJISË, NË PARIS

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralëjtënant Arben Kingji mori pjesë në Forumin e Mbrojtjes dhe Strategjisë, në Paris. Shefat e shtabeve të vendeve të BE-së, NATO-s dhe atyre partnere, u mbledhën në Forumin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, për të diskutuar mbi zhvillimet në mjedisin e sigurisë...



faqe 4



MINISTRI VENUGU: PËR NJË SHQIPËRI MË TË SIGURT, FOND 13 MILIONË EURO PËR MBROJTJEN CIVILE

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, pas mbledhjes së qeverisë bëri me dije për publikun se, Qeveria shqiptare ka miratuar një fond prej 13 milionë eurosh për njësitë vendore, fond i cili do të përdoret për investime në infrastrukturë, mjete, dhe rikonstruksion digash. Ministri i Mbrojtjes, u shpreh gjithashtu se u finalizua me sukses një...



faqe 2



NJË LIDER I ÇON NJERËZIT ATY KU DUAN TË SHKOJNË. NJË LIDER I MADH I ÇON NJERËZIT, JO ATY KU DUAN TË SHKOJNË, PO ATY KU DUHET TË JENË

Lidershipi është një element thelbësor për funksionimin dhe suksesin e çdo organizate, qoftë ajo ushtarake, politike, ekonomike apo sociale. Ne kemi nevojë për leadership për disa arsye kryesore që ndikojnë në zhvillimin dhe efektivitetin e grupeve dhe institucioneve. Liderët ofrojnë një vizion të qartë dhe një drejtim...



faqe 6

Ministri Vengu: Për një Shqipëri më të sigurt, fond 13 milionë euro për Mbrojtjen Civile

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, pas mbledhjes së qeverisë bëri me dije për publikun se, qeveria shqiptare ka miratuar një fond prej 13 milionë eurosh për njësitë vendore, fond i cili do të përdoret për investime në infrastrukturë, mjete, dhe rikonstrukcion digash.

Ministri i Mbrojtjes, u shpreh gjithashtu se u finalizua me sukses një punë voluminoze pas një periudhe konsultimi në 12 qarqet e vendit bashkë me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

Më tej ministri u shpreh se: “Tashmë, njësitë vendore në të gjithë Republikën e Shqipërisë mund të nisin nga puna për të forcuar edhe më shumë sistemin e Mbrojtjes Civile, në mënyrë që parandalimi i katastrofave natyrore të bëhet në kohë për të evituar dëmet. Këshilli i Ministrave miratoi listën e projekteve që njësitë kanë propozuar dhe që parashikojnë investimet në infrastrukturë, mjete, rikonstrukcion digash. 13 milionë euro do të shkojnë për këtë qëllim në mënyrë që bashkitë e të gjithë vendit të nisin sa më parë nga puna për implementimin e projekteve që do ta bëjnë Shqipërinë më të sigurt”.



Zëvendësministria e Mbrojtjes, Blerina Abrazhda takon efektivët e FA-së në KFOR

Gjatë qëndrimit në bazën e NATO-s, zëvendësministria e Mbrojtjes zhvilloi një takim me komandantin e bazës, kolonel Francesco Errico, të cilin e falënderoi për leadershipin dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj kontingjenteve shqiptare me mision në KFOR, Pejë, Kosovë. Nga ana e tij, Kolonel Errico shprehu vlerësimet më të larta për kontributin e kontingjentit shqiptar, duke e cilësuar atë një shembull të përkushtimit, disiplinës dhe profesionalizmit në përmbushjen e detyrave operacionale sipas standardeve të NATO-s.

Me rastin e 8 Marsit, Ditës Ndërkombëtare të Gruas, zëvendësministria e Mbrojtjes zhvilloi një bashkëbisedim me efektivet gra dhe vajza të kontingjentit të Forcave të Armatosura, duke i përgëzuar për sakrificën, profesionalizmin dhe forcën e tyre. Ajo vlerësoi rolin e tyre të pazëvendësueshëm, jo vetëm brenda Forcave të Armatosura, por edhe në misionet ndërkombëtare, ku ato dëshmojnë aftësi të larta ushtarake, përkushtim dhe leadership.

Zëvendësministria garanto mbështetjen maksimale të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për të gjitha kontingjentet e Forcave të Armatosura, që shërbejnë në misione të drejtuara nga NATO, BE dhe OKB.

Në përfundim të vizitës, gjatë takimit me katër kontingjentet e FA-së të dislokuara në Pejë, zëvendësministria Abrazhda shprehu mirënjohje për punën dhe përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, duke falënderuar të gjithë ushtarakët shqiptarë, të cilët me dinjitet dhe vendosmëri nderojnë uniformën dhe flamurin kombëtar në çdo mision ku shërbejnë.



MINISTRI I MBROJTJES VËNGU: NEGOCIATA ME 5 KOMPANI NDËRKOMBËTARE PËR PRODHIM ARMËSH

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu deklaroi nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë se 21 kompani kanë shprehur interesin për të bashkëpunuar me kompaninë shtetërore për prodhimin e armëve.

Në fjalën e tij ministri më tej u shpreh se: “Për industrinë ushtarake, janë vendosur themelet rregullatore me kompaninë shtetërore, që ka rigrupuar pesë asete dhe kemi marrë 21 shprehje interesi zyrtare nga kompani ndërkombëtare prodhimi municionesh, artilerie, dronësh luftarakë. Po zhvillojmë negociata me pesë prej tyre dhe shumë shpejt do jemi në gjendje, pse jo, dhe pranë komisionit të Sigurisë të japim një pasqyrë të qartë të të gjithë ecurisë së negociatave”.

Gjithashtu ministri tha se: “VKM për rikthimin në shërbimin aktiv është në proces bashkërendimi me Këshillin e Ministrave dhe shumë shpejt do të miratohet. S’ka ditë që qendra e rekrutimit nuk merr kërkesa për rikthim qoftë të ish-ushtarakëve, ish-gardistëve, elementë të tjerë që kanë qenë të përfshirë në sigurinë kombëtare që duan të angazhohen në FA. Kemi përparësi që ta miratojmë së shpejti”.

Ministri informoi se, komponenti rezervist po ashtu ka interes të lartë dhe ligji është miratuar, teksa aktet nënligjore, 5 prej tyre janë në bashkërendim, një paketë e plotë kjo që do të miratohet njëherazi në Këshillin e Ministrave.

Sa i takon statusit të ushtarakut ministri Vengu tha se, “Projektligji ka kaluar në konsultim publik me një seri përmirësimesh dhe po bashkërendohet gjithashtu me Ministrinë e Drejtësisë dhe atë të Financave për elementët financiarë”.



DREJT PËRFUNDIMIT RIDIMENSIONIMI I KAMPUSIT SPORTIV, SIMBOLIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Kampusi sportiv, i ridimensionuar tashmë, në garnizonin “Skënderbej” pritet të hapë dyert brenda pak javësh. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, inspektuan punimet e fundit të terrenit sportiv.

Kampusi sportiv i ridimensionuar përbëhet nga një investim domethënës që përfshin: fushë futbollit (100x67 m), pistë vrapimi me 4 korsi, fusha basketbolli, volejboli dhe tenisi, hapësira për atletikë dhe kërcim së gjati.

Në fazën përfundimtare të punimeve do të përfshihet edhe ndriçimi i plotë i kompleksit. Kampusi sportiv ka ruajtur elementët e tij origjinalë, duke mbajtur identitetin e tribunave dhe shkallëve, një simbol i rëndësishëm për Forcat e Armatosura.






Gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në Forumin e Mbrojtjes dhe Strategjisë, në Paris

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në Forumin e Mbrojtjes dhe Strategjisë, në Paris. Shefat e shtabeve të vendeve të BE-së, NATO-s dhe atyre partnere, u mbledhën në Forumin e Mbrojtjes dhe Sigurisë, për të diskutuar mbi zhvillimet në mjedisin e sigurisë, situatën në Ukrainën dhe nevojën për rritjen e kapaciteteve mbrojtëse në Europë. Një nga çështjet kryesore të diskutuara në Forum ishte forcimi i bashkëpunimit me SHBA-në, në përballimin e sfidave të sigurisë globale, duke theksuar rëndësinë e partneritetit transatlantik për stabilitetin dhe mbrojtjen e përbashkët.

Pjesëmarrësit në takim u përshëndetën nga presidenti i Francës Emanuel Macron, i cili pasi shprehu vlerësimet për këtë forum, ndau edhe këndvështrimin e tij për adresimin e sfidave të mbrojtjes dhe sigurisë në kontinentin Evropian.



Shqipëri - SHBA, stërvitje e përbashkët me dronë në Zall - Herr

Fusha e futbollit në Zall Herr u kthye në një pistë për dronët. Të përdorur jo vetëm për qëllime ushtarake, këta dronë mund të ndihmojnë në monitorimin dhe kontrollin e zjarreve.

E pranishme në këtë stërvitje ishte edhe e ngarkuara me punë e Ambasadës së SHBA-ve në Shqipëri, znj. Van Horn, e cila vëzhgoi ekipet tona duke punuar krah për krah, duke pilotuar dronët dhe duke u trajnuar me kompaninë e mortajave të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Kjo stërvitje thekson rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe SHBA-së, në forcimin e kapaciteteve dhe gatishmërisë për të përballuar sfidat e përbashkëta.



Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak me Mbretërinë e Bashkuar, po zhvillohet kursi "Junior Commanders Leadership Course", nën drejtimin e instruktorëve të Ekipit të Trajnimit Këshillues Ushtarak Britanik (BMATT), i cili synon të forcojë aftësitë e oficerëve të rinj në drejtim, vendimarrje dhe menaxhim të situatave operacionale, duke i përgatitur ata për sfidat e komandimit në të ardhmen.

Për FARSH kjo përkthehet në kapacitete njerëzore, të gatshëm për të drejtuar trupat në detyra, operacione dhe misione.



Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, priti ekipin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it

Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, priti ekipin e Gardës Kombëtare të New Jersey-it, për të koordinuar detajet e stërvitjes fushore që do të zhvillohet në prill 2025. Me pjesëmarrjen e studentëve ushtarakë të Gardës Kombëtare të New Jersey-it dhe atyre të Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë në AFA, kjo stërvitje synon rritjen e aftësive operacionale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar. Një hap tjetër i rëndësishëm për përgatitjen e liderëve të së nesërme në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.




Pesëgarëshi ushtarak është një garë që teston kufijtë fizikë dhe mendorë të pjesëmarrësve, përmes disiplinave që përfshijnë vrapimin, kalimin e pengesave, qitjen me armë, hedhjen e granatës dhe vrapimin. Suksesi i studentëve të AFA-së është një tregues i qartë i standardeve të larta të trajnimit dhe përgatitjes në këtë institucion.



EOD, misioni në emër të jetës edhe përtej kufijve shqiptarë

Trupat tanë EOD me mision në Letoni, gjatë operacionit për pastrimin e terrenit stërvitor nga eksplozivë të pa plasur, duke garantuar një mjedis të sigurt.



Forcat xheniere përfunduan me sukses ndërtimin e dy urave “Bailey”, në Mirditë

Forcat xheniere të Forcave të Armatosura të Shqipërisë kanë përfunduar me sukses ndërtimin e dy urave tip “Bailey”, duke përmbushur nevojat e komunitetit në dy zona të ndryshme të vendit. Ura në lagjen Klos, në fshatin Fan, të Mirditës ka një gjatësi prej 27 metrash, me kapacitet mbajtës deri në 40 tonë. Ura do t’u shërbejë rreth 600 banorëve të zonës dhe shumë vizitorëve të tjerë, që kalojnë fundjavat në këtë zonë. Ajo lidh fshatin Fan me një shkollë 9-vjeçare, një shkollë fillore, një qendër shëndetësore, si dhe ofron lidhje të drejtpërdrejta me Rrugën e Kombit. Ndërsa ura në lagjen Caraj, Perlat i Epërm ka gjithashtu një kapacitet mbajtës deri në 40 tonë. Për ndërtimin e kësaj ure janë angazhuar 10 forca dhe 3 mjete për një periudhë dhjetëditore. Ura lidh rreth 450 banorë, duke ofruar lehtësi kalimi për nxënësit e shkollës 9-vjeçare, lidhjen me qendrën shëndetësore, si dhe me rrugën Rrëshen-Lurë. Ajo gjithashtu mundëson akses në disa atraksione turistike të rëndësishme, si Shpella e Valit dhe fshatin Lufaj, duke ofruar mundësi për ecje në natyrë dhe hiking. Ky projekt është një kontribut i rëndësishëm i Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes për zhvillimin e infrastrukturës në këto zona, duke përmirësuar lidhjet dhe mundësitë për banorët dhe vizitorët, si dhe duke siguruar kushte më të mira për transport dhe akses në shërbime publike.



Forcat xheniere të KM përfunduan ndërtimin e urës “Bailey”, në Njësinë Administrative Polis, Librazhd

Në lagjen Sheh Polis, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd, është instaluar një urë e re me gjatësi 9 metra dhe kapacitet mbajtës deri në 40 tonë. Ky investim i rëndësishëm, i cili u përfundua në vetëm 4 ditë, do t’i shërbejë drejtpërdrejt rreth 150 banorëve të zonës. Falë kësaj ure, lidhja me qendrën shëndetësore dhe shkollën 9-vjeçare është më e sigurt dhe më e qëndrueshme, duke përmirësuar ndjeshëm cilësinë e jetës për komunitetin lokal.



NJË LIDER I ÇON NJERËZIT ATY KU DUAN TË SHKOJNË. NJË LIDER I MADH I ÇON NJERËZIT, JO ATY KU DUAN TË SHKOJNË, PO ATY KU DUHET TË JENË



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Lidershipi është një element thelbësor për funksionimin dhe suksesin e çdo organizate, qoftë ajo ushtarake, politike, ekonomike apo sociale. Ne kemi nevojë për leadership për disa arsye kryesore që ndikojnë në zhvillimin dhe efektivitetin e grupeve dhe institucioneve. Liderët ofrojnë një vizion të qartë dhe një drejtim strategjik, duke ndihmuar grupet ose organizatat të ecin përpara me qëllime të qarta. Pa një leadership të mirë, individët dhe grupet mund të humbasin fokusin dhe të mos arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Një ushtri, pa një lider të fortë mund të jetë e paorganizuar dhe e paaftë për të përballuar sfidat e betejës.

Në biznes, Një kompani pa një CEO vizionar mund të humbasë konkurrencën në treg.

Një lider i mirë motivon dhe frymëzon njerëzit për të arritur qëllimet e tyre. Ai ndihmon individët të kapërcejnë frikën, të tejkalojnë vështirësitë dhe të punojnë me përkushtim.

Një trajner sportiv frymëzon ekipin e tij të japë më të mirën në çdo ndeshje. Një mësues i aftë mund të frymëzojë nxënësit të ndjekin ëndrrat e tyre.

Lidershipi është thelbësor për strukturën dhe organizimin e një ekipi. Një lider e ndan punën, vendos përparësi dhe siguron që të gjithë të punojnë së bashku drejt një objekti të përbashkët.

Një lider ushtarak siguron që njësitë të jenë të koordinuara në një operacion. Në situata të ndërlikuara ose krize, një lider i aftë merr vendime të shpejta dhe të drejta. Pa një lider efektiv, vendimet mund të jenë të ngadalta, të pasakta ose të ndikuara nga kaosi. Në një situatë emergjente, një komandant ushtarak vendos për lëvizjet e trupave për të shmangur rrezikun.

Lidershipi është thelbësor në çdo fushë të jetës. Ai siguron drejtim, motivim, organizim, vendimmarrje të zgjuar dhe përshtatje ndaj ndryshimeve. Pa leadership të fortë, shoqëritë, organizatat dhe kombet mund të dështojnë të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Një lider i mirë nuk është vetëm një komandues, por një vizionar, motivues dhe drejtues që ndihmon të tjerët të ecin përpara me besim dhe sukses.

Lidershipi Ushtarak

Lidershipi ushtarak është një aspekt kyç në menaxhimin dhe komandimin e forcave të armatosura. Ai përfshin aftësinë për të motivuar, drejtuar dhe organizuar ushtarët në kushte të ndryshme, shpesh në situata me rrezik të lartë dhe nën presion ekstrem. Lidershipi ushtarak është zhvilluar ndër shekuj dhe është përshtatur me ndryshimet në teknologji, strategji dhe politika ushtarake.

Karakteristikat Kryesore të Lidershipit Ushtarak

Lidershipi ushtarak karakterizohet nga disa cilësi themelore që e dallojnë nga format e tjera të leadershipit:

Vendosmëria dhe Qartësia në Vendimmarrje

Një lider ushtarak duhet të jetë i aftë të marrë vendime të shpejta dhe të sakta, shpesh me informacion të kufizuar dhe nën presion. Një vendim i mirë në kohën e duhur mund të jetë diferenca midis fitores dhe humbjes në një betejë.

Integriteti dhe Disiplina

Lidershipi ushtarak kërkon një nivel të lartë etike dhe përgjegjësie. Oficerët dhe komandantët duhet të jenë modele të disiplinës, duke zbatuar dhe respektuar rregullat dhe normat ushtarake.

Aftësia për të Frymëzuar dhe Motivuar

Një lider i suksesshëm ushtarak nuk është vetëm një



komandant, por edhe një burim frymëzimi për trupat e tij. Kjo bëhet përmes shembullit personal, komunikimit efektiv dhe aftësisë për të krijuar një ndjenjë uniteti dhe misioni të përbashkët.

Përshtatshmëria dhe Fleksibiliteti

Në një mjedis që ndryshon vazhdimisht, siç janë fushëbetejat, një lider ushtarak duhet të jetë në gjendje të përshtatet me situatat e reja dhe të ndryshojë strategjinë sipas nevojës.

Modelet e Lidershipit Ushtarak

Lidershipi ushtarak mund të klasifikohet në disa modele, në varësi të qasjes që përdor lideri për të drejtuar trupat e tij:

Lidershipi Autokratik

Ky është një stil i udhëheqjes ku komandanti merr vendime pa konsultuar vartësit. Ky model është i dobishëm në situata ku është e nevojshme një përgjigje e shpejtë dhe e unifikuar, por mund të jetë problematik në situata që kërkojnë kreativitet dhe fleksibilitet nga ushtarët.

Lidershipi Transformues

Liderët transformues frymëzojnë dhe motivojnë ushtarët duke krijuar një vizion të qartë dhe duke promovuar inovacionin. Ky stil leadershipi ndihmon në krijimin e një kulture të përkushtimit dhe zhvillimit të aftësisë.

Lidershipi Demokratik (Bashkëpunues)

Në këtë stil, liderët përfshijnë vartësit në procesin e vendimmarrjes. Edhe pse ky model nuk është gjithmonë i mundur në operacione të drejtpërdrejta ushtarake, ai mund të jetë efektiv në fazat e planifikimit dhe trajnimit.

Si dhe stili i leadershipit që funksionon në çdo situatë.

Liderët duhet të përshtaten me rrethanat dhe të ndryshojnë qasjen e tyre sipas nivelit të pjekurisë dhe kompetencës së trupave të tyre.

Sfidat e Lidershipit Ushtarak në Kohët Moderne

Me zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet në natyrën e konflikteve, leadershipi ushtarak përballlet me sfida të reja si: Luftërat Asimetrike dhe Konfliktet Hibride. Luftërat moderne nuk zhvillohen vetëm midis ushtrive konvencionale, por përfshijnë edhe konflikte hibride, ku grupet paramilitare, kibernetika dhe operacionet psikologjike luajnë një rol të rëndësishëm. Liderët ushtarakë duhet të jenë të përgatitur për të menaxhuar situata të ndërlikuara dhe të paparashikueshme.

Teknologjia dhe Lidershipi Ushtarak

Përdorimi i inteligjencës artificiale, dronëve dhe luftës kibernetike ka ndryshuar natyrën e komandimit dhe kontrollit. Liderët modernë duhet të jenë të aftë të kuptojnë dhe të përdorin teknologjitë e reja në avantazhin

e tyre.

Liderët ushtarakë duhet të jenë të aftë të menaxhojnë stresin dhe të ruajnë moralin e trupave edhe në situata ekstreme. Konfliktet e gjata, traumat psikologjike dhe presionet politike mund të ndikojnë në performancën dhe efektivitetin e ushtrisë.

Historia ka prodhuar shumë liderë të shquar ushtarakë që kanë lënë gjurmë me aftësitë dhe strategjitë e tyre:

Aleksandri i Madh ishte një nga gjeneralët më të mëdhenj të historisë, i njohur për aftësinë e tij për të udhëhequr trupa të ndryshme dhe për të përdorur strategji inovative.

Napoleon Bonaparti, i famshëm për taktikat e tij ushtarake dhe aftësinë për të motivuar ushtarët e tij.

George S. Patton, gjeneral amerikan në Luftën e Dytë Botërore, i njohur për stilin e tij agresiv dhe strategjitë efektive në fushëbetejë.

Lidershipi ushtarak është një disiplinë e ndërlikuar që kërkon një kombinim të aftësive strategjike, emocionale dhe teknike. Një lider i suksesshëm ushtarak duhet të ketë integritet, vendosmëri, fleksibilitet dhe aftësi për të frymëzuar trupat.

Në kohët moderne, sfidat e reja si teknologjia, konfliktet asimetrike dhe presionet politike kërkojnë që liderët ushtarakë të jenë më të adaptueshëm se kurrë më parë. Pavarësisht këtyre ndryshimeve, parimet themelore të leadershipit ushtarak mbeten të njëjta, vendimmarrje e shpejtë, disiplinë e hekurt dhe aftësia për të motivuar dhe drejtuar forcat me sukses.

Disa prej lidershipëve me dominim në ushtrinë shqiptare

Lidershipi ushtarak shqiptar ka kaluar nëpër disa periudha të rëndësishme historike, duke pasur figura të shquara që kanë ndikuar në zhvillimin e forcave të armatosura dhe në mbrojtjen e sovranitetit të vendit.

Skënderbeu (Gjergj Kastrioti), Udhëheqësi i Lidhjes së Lezhës (1443-1468)


Skënderbeu është figura më e njohur e historisë ushtarake shqiptare dhe një nga strategët më të mëdhenj të Mesjetës. Ai u kthye nga Perandoria Osmane për të udhëhequr shqiptarët kundër pushtimit osman, duke përdorur taktika të luftës guerile dhe mbrojtje të fortifikuar.

Kontributi i tij konstatoi në: Bashkimin e principatave shqiptare nën Lidhjen e Lezhës; Mbajti Shqipërinë të pavarur për mbi 25 vjet kundër Perandorisë Osmane; U bë një simbol i rezistencës dhe leadershipit ushtarak.





Ali Pashë Tepelena (1740-1822), Sundimtari i Janinës
Ali Pashë Tepelena ishte një figurë karizmatike dhe një udhëheqës ushtarak që ndërtoi një shtet gjysmë të pavarur brenda Perandorisë Osmane. Ai ishte një strateg i shkëlqyer dhe shquhej për aftësinë e tij për të ndërtuar një ushtri të fuqishme lokale.
Kontributi i tij: Krijoi një ushtri të organizuar dhe modernizoi strukturat ushtarake; Luftoi kundër osmanëve dhe fuqive të tjera rajonale për të ruajtur pavarësinë e tij. Ishte një lider i aftë diplomatikisht dhe ushtarakisht.



Isa Boletini (1864-1916), Hero i Pavarësisë
Isa Boletini ishte një nga komandantët kryesorë të luftës për pavarësinë e Shqipërisë. Ai organizoi dhe drejtoi luftëtarët shqiptarë kundër Perandorisë Osmane dhe forcave serbe.
Kontributi i tij: Pjesëmarrje aktive në shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912; Luftoi kundër forcave serbe për të mbrojtur trojet shqiptare. U bë një figurë simbolike e rezistencës kombëtare.



Ahmet Zogu (1895-1961), Mbret dhe Udhëheqës i Ushtrisë Shqiptare
Ahmet Zogu, fillimisht kryeministër dhe më pas mbret i Shqipërisë, pati një rol të rëndësishëm në krijimin e ushtrisë shqiptare moderne gjatë viteve 1920-1930.
Kontributi: Organizoi dhe centralizoi ushtrinë shqiptare; Forcoi institucionet ushtarake dhe krijoi Akademinë Ushtarake; Mbajti një politikë të mbrojtjes kombëtare kundër ndërhyrjeve të jashtme.



Enver Hoxha (1908-1985), Komandant i Ushtrisë Partizane dhe Udhëheqës i Shtetit
Enver Hoxha ishte lideri i Luftës Nacionalçlirimtare dhe komandanti kryesor i forcave partizane që luftuan kundër pushtuesve italianë dhe gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore.
Kontributi: Udhëhoqi luftën partizane dhe çlirimin e Shqipërisë më 1944; Pas luftës, krijoi një ushtri të madhe me bazë ideologjike komuniste; Konstruktimi i bunkerëve dhe doktrina e “mbrojtjes popullore” përgatiti vendin për çdo sulm të mundshëm të jashtëm.



Mehmet Shehu (1913-1981), Gjeneral dhe Kryeministër
Mehmet Shehu ishte një nga komandantët kryesorë të Luftës Nacionalçlirimtare dhe më vonë u bë kryeministër i Shqipërisë, duke mbajtur kontroll të fortë mbi ushtrinë.
Kontributi: Reformoi ushtrinë dhe e forcoi në bazë të modelit sovjetik dhe kinez; Ndërtoi sistemin e fortifikimeve dhe bunkerëve në Shqipëri.
Ishte një nga strategët më të rreptë të epokës komuniste.
Kudusi Lama, Gjeneral i Ushtrisë Shqiptare gjatë viteve 1990
Kudusi Lama ishte një nga figurat kyçe në riorganizimin e ushtrisë shqiptare pas rënies së komunizmit. Ai ndihmoi në transformimin e ushtrisë nga një model komunist në një ushtri më të standardizuar sipas NATO-s.
Kontributi: Modernizoi strukturat ushtarake të Shqipërisë; U angazhua në integrimin e ushtrisë



shqiptare në standardet perëndimore; Mbështeti reformat për anëtarësimin e Shqipërisë në NATO.
Bajram Begaj, President dhe ish-shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare
Bajram Begaj, i cili ka shërbyer si shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe më pas u zgjodh President i Republikës, ka luajtur një rol kyç në transformimin e ushtrisë shqiptare në epokën moderne.
Kontributi: Drejtoi modernizimin dhe profesionalizimin e ushtrisë shqiptare; Përforcoi partneritetin me NATO-n dhe fuqizoi



rolin e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare; Përfaqësoi një brez të ri të liderëve ushtarakë të angazhuar në standardet globale të mbrojtjes.
Lidershipi ushtarak shqiptar ka evoluar nga strategët mesjetarë si Skënderbeu te liderët modernë të integruar në NATO. Çdo periudhë historike ka prodhuar liderë që kanë përshtatur strategjinë dhe organizimin ushtarak sipas sfidave të kohës.
Sot, Shqipëria është pjesë e NATO-s dhe ushtria e saj po kalon një fazë modernizimi dhe profesionalizimi, duke reflektuar një qasje të re strategjike për sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare.
Lidershipët e rinj të ushtrisë shqiptare dhe botëkuptimi i tyre në drejtim



Lidershipi i ri i Forcave të Armatosura të Shqipërisë po përqafton një qasje moderne dhe të integruar në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe angazhimet e vendit në aleanca si NATO. Ky transformim reflekton një botëkuptim të orientuar drejt profesionalizmit, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe përshtatjes ndaj sfidave të reja të sigurisë.
Karakteristikat kryesore të këtij botëkuptimi
Profesionalizimin dhe Edukimi i Avancuar: Liderët e rinj ushtarakë theksojnë rëndësinë e arsimit të lartë ushtarak dhe trajnimeve specifike për të rritur aftësitë strategjike dhe operacionale.
Integrimin në Strukturat Ndërkombëtare: Me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, leadershipi ushtarak është fokusuar në harmonizimin e procedurave dhe standardeve me ato të aleatëve, duke marrë pjesë aktive në misione paqeruajtëse dhe stërvitje të përbashkëta.
Përdorimi i Teknologjisë së Avancuar: Adoptimi i teknologjive moderne në komunikim, mbikëqyrje dhe logjistikë është një prioritet për të përmirësuar efikasitetin dhe reagimin e shpejtë të forcave të armatosura.
Përshtatja ndaj Kërcënimeve të Reja: Liderët e rinj janë të vetëdijshëm për sfidat e sigurisë kibernetike, terrorizmit dhe kërcënimeve asimetrike, duke zhvilluar strategji për t'u përballur me to në mënyrë efektive.
Transparenca dhe Llogaridhënia: Në përputhje me reformat demokratike, ushtria po promovon një kulturë transparence dhe llogaridhënieje, duke forcuar besimin e publikut dhe duke siguruar një menaxhim të përgjegjshëm të burimeve.
Ky botëkuptim i ri synon të sigurojë që Forcat e Armatosura të Shqipërisë të jenë të gatshme dhe të afta për të mbrojtur interesat kombëtare, duke kontribuar njëkohësisht në paqen dhe stabilitetin rajonal dhe global.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Teknologjia nuk është jetë...

Kam kaluar një orë në bankë me babanë, sepse ai duhej të bënte një transfertë. Nuk e mbajta dot veten, ndaj e pyeta... “Babi, pse nuk e aktivizojmë llogarinë tënde bankare në internet?”, “Pse do ta bëja këtë?”, - me pyeti ai...

“Epo, sepse atëherë nuk do të të duhej të kaloje një orë këtu për gjëra të tilla si transfertat bankare. Dhe pastaj mund të bësh edhe disa blerje në internet. Gjithçka do të ishte kaq e thjeshtë!”. Isha në qiellin e shtatë për t'i hapur atij botën e llogarisë bankare online.

Ai më pyeti: “Nëse do ta bëja këtë, a do të mund të dilja më nga shtëpia?”

“E saktë!”, - i thashë. Pastaj i shpjegova se tani mund t'i dërgonte edhe sendet ushqimore në shtëpinë e tij dhe se mund të blente çdo gjë në ‘Amazon’.

Përgjigja e tij më la pa fjalë: “Që kur kam hyrë sot në bankë, kam takuar katër nga miqtë e mi dhe kam biseduar me stafin që tani më njeh shumë mirë. Ti e di që jam vetëm... kjo është shoqëria që më duhet. Më pëlqen të përgatitem për të ardhur në bankë. Kam mjaft kohë dhe kjo është pikërisht ajo që më duhet edhe si një lloj stërvitje fizike. Dy vjet më parë, kur isha i sëmurë, më erdhi për vizitë shitësja e perimeve, tek e cila blej fruta dhe u ul pranë shtratit tim dhe qau.

Kur nëna jote u rrëzua disa ditë më parë teksa po ecte në mëngjes, tregtari ynë i besuar e pa dhe mori menjëherë makinën për ta çuar në shtëpi, pasi ai e di se ku jetojmë.

A do ta kisha gjithë këtë humanizëm nëse gjithçka do ta zgjidhja në internet? Pse do të zgjidhja që gjithçka ta merrja të gatshme dhe të detyrohesha të bashkëveproja vetëm me kompjuterin tim?

Më pëlqen të njoh njerëzit me të cilët kam të bëj dhe jo vetëm “shitësit”. Kështu mund të krijoj lidhje dhe marrëdhënie me njerëzit. A m'i jep ‘Amazon’ këto?” Teknologjia nuk është jetë...

Ne duhet ta kalojmë kohën tonë me njerëzit, jo me pajisjet.

Teknologjia na ofron komoditet dhe efikasitet, por a e zëvendëson dot ngrohtësinë dhe ndjenjën e përkatësisë që sjellin kontaktet njerëzore?

Teknologjia është një mjet, jo një zëvendësues për jetën reale. Ndërsa ajo e bën jetën më të thjeshtë, nuk duhet ta lejojmë të na shkëpusë nga ndërveprimet njerëzore që e pasurojnë shpirtin tonë. Jeta nuk është vetëm efikasitet, është përvoja, ndjesia dhe lidhjet me të tjerët.



Njerëz mos harroni të jetoni jashtë ekranit të pajisjeve elektronike

Sa e bukur është të jetosh mes njerëzve sepse, ndajmë gëzime dhe hidhërime, kur festojmë, gëzimi bëhet më i madh me të tjerët, kur kemi sfida, një fjalë e ngrohtë nga dikush na jep forcë.


Mësojmë dhe rritemi nga çdo person që takojmë, ka diçka për të na mësuar, një histori për të ndarë, një përvojë për të përcjellë.

Ndajmë përkatësi, një përshëndetje e ngrohtë, një bisedë e rastësishme, një ndihmë e dhënë pa pritur kthim, të gjitha këto na bëjnë të ndihemi pjesë e diçkaje më të madhe.

Jeta bëhet më e pasur...

Nuk janë vetëm vendet apo objektet që e bëjnë jetën të bukur, por momentet e kaluara me njerëzit që duam. Një përqafim i singertë, një buzëqeshje e papritur, një kujtim i bukur i ndarë

NDJESITË NJERËZORE NUK MUND TË PROGRAMOHEN, NUK MUND TË MATEN ME ALGORITME, KY ËSHTË ‘LIGJ’ I JETËS



Teknologjia na zbehur shkëmbimin e ndjenjave njerëzore

Në një farë mënyre, teknologjia ka ndikuar në zbehjen e shkëmbimit të ndjenjave njerëzore, duke zëvendësuar shumë ndërveprime të drejtpërdrejta me komunikime virtuale.

Më shumë lidhje, më pak afërsi. Mund të komunikojmë me këdo, kudo, por a po e ndiejmë njëri-tjetrin po aq sa dikur?

Shkurtimi i bisedave, emoji dhe mesazhet e shkurtra nuk mund të zëvendësojnë shikimin në sy dhe emocionet e singerta të një bisede ballë për ballë.

Më shumë ekran, më pak ndjenja, momente që dikur ndaheshin me njerëzit përreth, tani postohen në rrjete sociale, duke na larguar nga ndjesia e vërtetë e përvojave të përbashkëta.

Mungesa e kontaktit fizik, një përqafim, një shtrëngim dore, një prekje në sup kur dikush ka nevojë, këto janë gjëra që asnjë mesazh nuk mund t'i zëvendësojë.

A ka ende shpresë?

Teknologjia është një mjet, jo një zëvendësues i ndjenjave. Nëse e përdorim me kujdes, ajo mund të na afrojë, jo të na largojë. Duhet të gjejmë ekuilibrin, të përdorim teknologjinë për lehtësi, por të mos harrojmë të jetojmë e të ndiejmë në botën reale.

A ka më hyjnore se të jesh pranë njerëzve fizikisht

Të jesh pranë dikujt nuk është thjesht një afërsi trupore, por një ndjesi shpirtërore e thellë.

Kur jemi pranë njëri-tjetrit, ndiejmë energjinë dhe shpirtin e tjetrit, diçka që asnjë ekran nuk mund ta përcjellë.

Përqafimi ka një fuqi shëruese që fjalët nuk mund ta zëvendësojnë, shikimi në sy është një lidhje e heshtur, një gjuhë e shpirtit.

Bashkëjetesa me natyrën dhe me njerëzit na bën të ndihemi pjesë e diçkaje më të madhe, një ekuilibër i përsosur i krijimit hyjnor.

Zoti nuk e krijoi njeriun për të jetuar vetëm. Ne jemi të ndërtuar për dashuri, ndarje emocionesh dhe për të ndier ngrohtësinë e njëri-tjetrit. Asgjë nuk e zëvendëson prezencën fizike, sepse aty gjendet vetë shpirti i jetës.

Prezenca fizike është thelbi i lidhjes njerëzore, në momentin kur je pranë dikujt, nuk ka nevojë për fjalë të tepërta, mjafton një vështrim, një buzëqeshje, një prekje në sup për të ndjerë gjithë atë ngrohtësi dhe dashuri që s'mund të përkthehet në mesazhe apo ekrane.

Jemi pjesë e diçkaje më të madhe, komuniteti, familja, miqtë, janë ata që na japin kuptim dhe i japin shpirt ditëve tona.

Teknologjia mund të na lidhë, por zemra e vërtetë e jetës është aty ku njerëzit takohen, prekin, qeshin dhe ndajnë momente të paharrueshme.

Teknologjia dhe inteligjenca artificiale mund të ndihmojnë, mund të lehtësojnë jetën, por kurrë nuk mund të zëvendësojnë marrëdhëniet njerëzore.

Dashuria, miqësia, dhe ndjenjat e singerta nuk mund të programohen, nuk mund të maten me algoritme. Shpirti njerëzor është diçka hyjnore, diçka që asnjë makinë nuk mund ta kuptojë plotësisht.

Lidhjet njerëzore duhet të mbeten të pastra, të natyrshme, të ndërtuara me kohë dhe përkushtim, larg ndërhyrjes së çdo teknologjie.

Inteligjenca artificiale mund të jetë një mjet, por kurrë një zëvendësim për ngrohtësinë e një përqafimi, ndjenjën e

një prekjeje të butë, ose thellësinë e një bisede nga zemra.

Ne duhet ta jetojmë jetën me njerëzit, jo me ekranet

Pajisjet janë mjete, por njerëzit janë jeta, teknologjia na ndihmon, por nuk duhet të na largojë nga njëri-tjetri. Nuk ka asgjë më të vlefshme se një bisedë e singertë, një shëtitje me dikë të dashur, një darkë e ngrohtë me familjen.

Një mesazh nuk mund të zëvendësojë një përqafim. Një video-call nuk mund të zëvendësojë shikimin sy më sy. Një 'like' nuk mund të zëvendësojë ndjenjën e vërtetë të mbështetjes.

Le të kthehemi tek momentet reale, tek buzëqeshjet e ndjera, tek premtimet e mbajtura dhe tek përjetimet që nuk mund të ruhen në një ekran, të zëvendësojë një buzëqeshje të vërtetë.

Teknologjia mund të ndihmojë, por ajo nuk mund të krijojë kujtime, nuk mund të dhurojë përqafime dhe nuk mund të zëvendësojë një buzëqeshje të vërtetë

Në botën e sotme, teknologjia ka marrë një rol qendror në jetën tonë. Ajo na ndihmon të komunikojmë më lehtë, të mësojmë më shpejt dhe të zgjidhim probleme me efikasitet. Megjithatë, sado e avancuar të jetë, teknologjia nuk mund të zëvendësojë ndjesitë e singerta që burojnë nga marrëdhëniet njerëzore.

Kujtimet, përqafimet dhe buzëqeshjet janë pjesë e shpirtit të jetës, dhe ato nuk mund të ruhen në një ekran apo të ndjehen përmes një pajisjeje. Kujtimet krijohen nga përjetimet, jo nga ekranet. Një foto e bukur mund të ruhet në telefon, por ndjenja e asaj dite të veçantë jeton në zemrat tona.

Një video mund të kapë një moment, por nuk mund të sjellë prapa aromën e detit, zhurmën e të qeshurave të miqve apo emocionin e një takimi të paharrueshëm.

Kujtimet më të bukura krijohen nga momentet që ndajmë me njerëzit, nga aventurat, nga bisedat e gjata dhe nga përjetimet e drejtpërdrejta.

Asnjë mesazh nuk mund të zëvendësojë një përqafim

Në momente të vështira, një mesazh ngushëllimi mund të jetë i vlefshëm, por një përqafim i singertë ka një forcë që nuk mund të matet. Përqafimi sjell ngrohtësi, ndjenjë sigurie dhe një lidhje të thellë që teknologjia nuk mund ta imitojë. Pavarësisht se mund të dërgojmë “emoji” me zemra apo përqafime virtuale, ato nuk mund të japin të njëjtën ndjenjë si një përqafim i vërtetë nga një mik apo familjar.

Një buzëqeshje e vërtetë është më shumë se një ikonë në ekran

Komunikimi online na lejon të shprehim emocionet tona përmes “emoji”-ve apo reagimeve në rrjetet sociale. Megjithatë, një buzëqeshje e singertë, e parë drejtpërdrejt, sjell një emocion që teknologjia nuk mund ta përcjellë plotësisht. Buzëqeshja e një miku që takojmë pas një kohe të gjatë, buzëqeshja e një fëmije kur sheh prindin, apo ajo e një të moshuari që ndjen ngrohtësinë e pranisë sonë, këto janë momente që nuk mund të zëvendësohen nga një ekran.

Teknologjia si mjet, jo si zëvendësues

Teknologjia është një mjet i fuqishëm që na lehtëson jetën, por ajo nuk duhet të na shkëpusë nga realiteti. Është e rëndësishme të gjejmë një ekuilibër mes botës dixhitale dhe jetës së vërtetë. Në vend që të humbasim në botën virtuale, le të krijojmë kujtime të vërteta, të përqafojmë më shpesh dhe të buzëqeshim ballë për ballë me ata që duam.

Në fund të fundit, jeta është më shumë se një ekran. Ajo është përjetim, ndjenjë dhe lidhje njerëzore.



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

DITA E VERËS – FESTË UNIKE E GJITHË SHQIPTARËVE



Profesor Zaho Golemi për shtypin ushtarak sjell një analizë mbi festën pagane të shqiptarëve “Ditën e Verës”. Çfarë përfaqëson për ne kjo festë?

Vite më parë “Dita e Verës” konsiderohej si “privilegj” i trevës së Elbasanit dhe trevës përreth, por që në forma të ndryshme festa pagane festohej edhe fshehtas dikur në të gjitha trevat e shqiptarisë. Ishte ekzakt 14 Marsi. Edhe në kohën e diktaturës gjendej një mënyrë për të festuar dhe gëzuar në Elbasan e Çermenikë, në Cërrik dhe Belsh, në Librazhd e Përrenjas dhe jo vetëm. Dita e Verës konsiderohej si dita e largimit të dimrit dhe që lajmëronte ardhjen e pranverës. Festohej dhe festohet edhe nga strukturat ushtarake dhe mbarë populli.

Legjenda e shikon zanafillën tek faltorja e Zanës së Çermenikës e ndërtuar në rrethinat e qytetit të Elbasanit, e cila ishte perëndesha e gjuetisë, pyjeve dhe e të gjithë natyrës në zemër të shqiptarisë. Legjenda thotë se “kjo zanë dilte nga faltorja e vet ditën e 14 marsit”. Dalja e Zanës shënonte fillimin e Verës, që për kohët pagane dallonin vetëm dy stinë, dimri dhe vera. Por a nuk dilte kjo zanë edhe në Çamëri, Labëri, Kosovë, Malësinë e Mbishkodrës, në çdo pyll të trevave shqiptare.

Një ditë vere e mbushur me lule, e ngrohtësi, me erëra që lajmëronin më shumë dritë dhe diell, bereqet e gëzime, duke përzënë në mënyrën e vet të ftohtit, të keqen, dhe ndillej e mira që pritej me lule e ëmbëlsira karakteristike. Kjo ditë ka shtrirje gjithë-shqiptare dhe në Kosovë. Dita e Verës nuk ishte vetëm e Elbasanit, por e mbarë trevave shqiptare, zakone që i kanë marrë me vete edhe diaspora shqiptare shekujve.

Legjenda përtej ballokumeve dhe veroreve bardhe kuq!

Nga ëmbëlsirat shumëkush njihet krye-mbretëreshën tradicionale të ëmbëlsirave “ballokumet”, por ka me dhjetëra ëmbëlsira, si i thotë maksima popullore “fshat e zanat”, ku nuk mungojnë verorja që është një lidhëse me dy ngjyra e bardhë dhe e kuqe, të cilën vajza, gra, meshkuj dhe fëmijë e vendosin në dorë një natë para ditës së verës. Është njëra nga mënyrat që lajmëron dhe simbolizon ardhjen e pranverës. Verorja është një objekt me vlerë që meriton plotësisht të mbrohet edhe nga UNESCO. Ato i heqim kur vijnë dallëndyshtet dhe i vëmë në pemë që t’i marrin ato për të bërë folenë, më karakteristike për vajzat në prag martesë. Ato verore që merren të parat për të ndërtuar foletë e dallëndysheve janë edhe “vajzat që kanë radhën e martesës”, thotë legjenda e lashtë që nga paganizmi.

Në lidhje me zanafillën e ditës së Verës dhe e largimit të dimrit lidhet në një farë mënyre edhe me besnikërinë e elbasanasve për “Ditën e Verës”, duke e bërë qytet të përkëdhelur nga fati, por mbi të gjitha nga mirësia njerëzore elbasanase. Elbasani është ndër qytetet më të njohur për tradita të veçanta kulturore dhe përtej tyre. Por festa e verës, që kremtohet në qytetin e njohur ndryshe “qyteti në kërthizë të Shqipërisë”, nuk është vetëm për elbasanasit.

Dhe tashmë kjo është e provuar plotësisht për ngrohtësinë që sjell kjo ditë. Shumë miq vijnë nga të gjitha zonat e vendit për të festuar ardhjen e verës, por edhe për të shijuar gatimet karakteristike të kësaj zone, si ballokumet dhe revaninë, të cilat në këtë ditë, sipas vendasve, “goditen” ndryshe nga herët e tjera, gjelin e detit, arrat apo palat e fikut, të cilat tradicionalisht iu dhurohen fëmijëve të vegjël, të cilët janë të parët që bëjnë vizita mbarësie nëpër shtëpitë e të afërmeve dhe të fqinjëve.

Është kjo arsyeja që Elbasani është mikpritës për t’iu sjellë edhe qytetarëve të tjerë shqiptarë për një verë më të ëmbël dhe plot ngjyra të bekuara dhe të solidarizuara për unitet më të fuqishëm me njeri-tjetrin. Një natë para Ditës së Verës, njerëzit mblidheshin më shpejt në shtëpitë e tyre, për të festuar së bashku me të afërmit epilogun e kësaj feste. Zgimi bëhej në të gdhirë dhe të moshuarit, herët në mëngjes, hapnin derën e shtëpisë për bujari, merrnin shtamën për ta mbushur me ujë të freskët dhe sillnin në shtëpi një plis bari të gjelbëruar, ndërkohë që të rinjtë plehëronin portokallet dhe ullinjë.

Respektimi i Ditës së Verës është respektim i natyrës, që të kenë një verë të shëndetshme e të mbarë. Simbolika e luleve është shumëllojshmëria me emërtime të jashtëzakonshme si: jasemini, karafilat, trëndafilat, lule që mbillen masivisht në të gjitha familjet, në qytet dhe në fshatra, me qëllim që të dhurohen lulet e tyre në ditën e verës për të afërmit. Dreka e kësaj dite në fakt është një rit plot humor dhe shijim për të gjithë elbasanasit, të cilët, zakonisht, e kalonin këtë drekë në natyrë, ku organizoheshin lojëra popullore dhe gjithfarë aktivitetesh.

Në Elbasan festohet edhe Nata e Verës, nata para ardhjes së saj, me mish, raki, gjel deti, ballokume, ëmbëlsira. Por gatimet fillojnë me byrekun me hithra, barishte pranverore si dhe gatime me receta të paimitueshme nga vende të tjera. Në këtë ditë, elbasanllinjët urojnë njëri-tjetrin për një jetë sa më të gjatë dhe të lumtur, ndërkohë që qyteti dhe jo vetëm hedh vellon e gëzimit dhe ia “rrëmben” emrin kryeqytet, Tiranës, të paktën për një ditë në vit.

Por byzylykët bashkëshoqërohen me ballokume dhe ushqime të larmishme të Elbasanit, janë edhe këngët e vallet, kostumet e grupeve folklorike nga qyteti dhe bashkitë e qarkut, që janë kaq seriozë në stafetën e argëtimit muzikor nga Elbasani, Librazhdi, Peqini, Gramshi, që axhendën e Ditës së Verës e kanë muzikalitetin e kohës sonë, të mbushur me muzikë popullore, ekspozita të punimeve artistanele, festime me kostumografi të zonave të ndryshme. Shitësit ambulantë në rrugë i japin një dimension të bukur festës pagane të ditës unike të Verës.

Rite të lashta, mirësi jetësore e “Ditës së Zotit”

Ëmbëlsira tradicionale e ballokumes ka “thyer” kufijtë e kryeqendrës së festimeve, sepse me ardhjen e qindra qytetarëve, nga rrethe të tjera të vendit, nga Maqedonia e Veriut dhe Kosova, por edhe nga diaspora nga vendet e largëta, për të “prekur” tempullin e shenjtë të Zanës së Çermenikës apo perëndeshës e hyjneshës së gjuetisë, pyjeve dhe gjithë natyrës “Diana”. Hapësirat arbërore që prej paganizmit në brigjet e Adriatikut dhe Jonit e kanë njohur edhe popujt fqinjë në thellësi të shekujve.

Kohët historike, ideologjike e besimtare, nuk mundën të shuanin zjarret purifikuese, për ta “ndihmuar” dhe për t’i dhënë forcë diellit në oborr e kopshte, me rite magjike për të “ndëshkuar” çdo qenie dëmtuese e grabitëse. Një ditë para ardhjes së ditës së verës, në disa zona njerëzit marrin tufa bari e lulesh të njomë me rrënjë, që ta kenë në mëngjesin e datës 14 Mars në shtëpi, si një rit i lashtë që ruhet dhe festohet në dhjetëra qytete të Shqipërisë në veri dhe në jug të vendit, sikurse edhe në Shqipërinë e mesme. Në disa treva shqiptare nuk mungonin dhe kurorat e luleve, që i varnin në portat e shtëpisë, për të sjellë fat, mbarësi dhe bollëk në të ardhura bujqësore e blegtorale.

Mendja njerëzore shekujve ka sjellë pasurimin dhe përsosjen e kësaj feste, duke sjellë edhe dimensione të humorit e gëzimit. Një gojëdhënë thotë se mëngjesin e Ditës së Verës kryhej edhe një rit tjetër disi i pazakontë, ku djem të moshës 7-8 vjeçare herët në mëngjes i binin çekiçit të portës së jashtme të familjeve fqinje. Nëse nga brenda dëgjohej zëri “Kush është?”, atëherë djemtë fillonin këngën me vargjet: “Marrsh morrat e pleshtat,/Gjumin e sabahut,/Ethet e verës,/Me çekiça derës...”, që simbolizonte largimin e të ligave nga porta, për t’ia lënë derës tjetër..., gojëdhëna të tilla ka me dhjetëra, që janë një pasuri interesante e popullit që trashëgohet brezave.

Faik Konica, Fan Noli dhe Mark Tirta për festën e ditës së Verës

Faik Konica për ditën e verës, më 1911 shkruan: “Ç’është Dita e Verës? Është dita në të cilën shtërgjyshërit t’anë, kur s’kish lindur edhe krishtërimi, kremtojin bashkë me Romanët dhe me Grekët e Vjetër, perënditë e luleve, të shëlgjeve, të krojeve. Kur çkrin dimëri (dëbora), kur gaset Vera buzëqeshur e hollë dhe e gjatë si në pikturë të Boticellit, zemra e njeriut çgarkohet nga një barë, shijon një qetësi, një lumtësi t’ëmbël. Në këtë gëzim, stërgjyshërit t’anë ndiejnë një detyrë t’u falen perëndive që sillnin këto mirësira. Dhe ashtu leu festa hiroshë që quajmë Ditë e Verës. Në pak ditë në Shqipëri, besnikët e fundmë të paganizmit, besnikë padashur dhe pa dijtur, do

të rrethojnë me verore degët e thanavet, të dëllinjave, të dafinavet të gjithë shëlgjeve të nderuara. Do t’këputin degë të gjelbra dhe do t’i vënë përmbi dyert e shtëpive dhe t’odave...”.

Tradita e festave që sjellin mirësi janë “festa të vjetëra të racës s’onë. Nuk i bëjnë dëm njeriu. Sjellin një gëzim të kulluar në shtëpitë. Në një vënt ku jeta e të vegjëlve është aq e trishtë, djelmuria dhe vajëzat kanë një rasë të rallë për të dëfryer. Për të mëdhenjtë, Dita e Verës ka një shie poetike të hollë e të rrallë...”. Shprehje plot kolorit ngjyrash që vjen në një stil të sofistikuar nga shkrimtari Faik Konica.

Ka edhe nga ata studiues që duke e ngatërruar e quajnë “festë arbëreshe”, duke harruar se arbëreshët e morën me vete këtë festë nga trojet e të parëve. Prof. Mark Tirta, studiuesi i shquar i etnografisë, kulturës, riteve e zakoneve të shqiptarëve dhe popujve të tjerë, e lidh Ditën e Verës me ringjalljen pranverore të natyrës në raport me dimrin që jep shpirt. Ritet e kësaj natyre janë të dokumentuara të paktën prej tre mijë vjetësh. Ai flet për një traditë mesdhetare, për të mos shkuar më tej. Dita e Verës ka qenë e lidhur me ditën e parë të marsit, sepse në antikitet marsi ishte muaj i parë i vitit, sipas kalendarit Julian.

Në Evropën Perëndimore, kalendarit Julian u zbatua derisa në vend të tij u vendos kalendarit Gregorian, edhe pse ende ruhen gjurmë të kalendarit Julian. Duhet që viti kalendarik të fillojë me marsin që muaji i shtatë të jetë shtatori, i teti tetori, i nënti nëntori dhe i dhjeti dhjetori. Emrat nuk kanë ndryshuar edhe pse nga 15 tetori 1582, datë kur hyri në fuqi reforma gregoriane, muajt janë respektivisht, muajt e nëntë, i dhjetë, i njëmbëdhjetë dhe i dymbëdhjetë.

Prof. Kristo Frashëri, argumenton se kalendarit i vjetër i shqiptarëve është edhe më i hershëm se kalendarit Julian, i cili u shpall nga Jul Çezari, më 46 p.e.s. Dita e parë e marsit shënonte, sikurse dhe sot, fillimin e stinës së pranverës, ndërkohë që ishte koha kur stinët ishin më të dallueshme nga njëra-tjetra se në kohën e ngrohjes globale që nuk kishte filluar ende. Njerëzit mezi prisnin që të dilnin nga dimri, të shkrinte bora, të gjelbërohej natyra, të çelnin lulet, të blegërinin qengjat, të loznin fëmijët fushave e kodrave, të gëzonin të gjithë. Para kjo ishte simbolika e ringjalljes së natyrës.

Tradicionalisht pelegrinazhet në Ditën e Verës bëheshin në majat më të larta të kodrave dhe të maleve kudo në Shqipëri, për të qenë sa më afër Perëndisë së Diellit, jetëdhënësit, para të cilit luteshin për begatinë përgjatë vitit të ri. Adhurimin e tyre për perëndinë e tyre “Diell”, shqiptarët e përjetësuam me emrin “e diel”, sikurse anglezët, ndryshe nga popujt e tjerë evropianë, të cilët e kanë emërtuar “Dita e Zotit”.

Ndërkohë poliedriku Fan Noli thoshte qartësisht, “...se pas dimrit, vjen një verë”, një verë shprese dhe gëzimesh shumëdimensionale në të gjitha planet. Sepse dita e Verës shoqërohej edhe me zjarre, zakonisht dëllinjash mbremëjeve, në mes të fshatit, të cilët i kapërcenin burrat e djemtë, si për t’i lënë lamtumirën dimrit dhe që sinjalizonin pranverën që po troket. Dita e Verës është festuar shumë kohë para se institucionet e besimit e, më pas, ato shtetërore të fillonin të administronin festat popullore edhe në Shqipëri, sepse ishte një festë e trashëguar pagane, e festuar që në lashtësi. Faik Konica ka një urim original për këtë festë: “Gëzim të kulluar pastë në shtëpinë e çdo shqiptari!”. Festa e ditës së Verës është pjesë e krenarisë, kulturës që rrjedh që nga hershmëria e shqiptarëve, traditave të mira dhe mirësisë njerëzore të shqiptarëve. Tashmë Dita e Verës është një ditë e shënjuar si dita kombëtare e shqiptarëve e njohur edhe juridikisht, duke shtuar një ditë në kalendarin e festave shqiptare.

NËNKOLONEL LEONARD MUSOLLARI

Është shumë e bukur dhe domethënëse kur ish-studentët kujtojnë me mall, mirënjohje dhe respekt profesorët e tyre, veçanërisht ata që kanë pasur një ndikim të madh në formimin e tyre si profesionistë dhe njerëz. Një prej tyre është dhe ish-skënderbegasi, sot oficer karriere, Leonard Musollari, i cili përmes kujtimeve të tij sjell në vëmendje të lexuesit ushtarak, dhe jo vetëm, në shenjë falënderimi ndaj misionit të këtyre njerëzve fisnikë, momente që shënjuan në jetën e tij dhe bashkudhëtarëve të rrugëtimit në uniformën e gjelbër.

Kujtoj me mall dhe mirënjohje mes dhjetëra profesorëve të mi, të nderuarin dhe mikun e dashur të shumë studentëve, profesor Skënder Zaimin.

Mbresa të “shpërndara” nëpër stacionet e jetës, ndalen për një çast tek vitet e shkollës Ushtarake “Skënderbej”. Ishim veç 14-vjeçarë, me kapotën dhe këpucët e rënda të ushtarit veshur, vështrimin e hutuar djaloshtar, nën ashpërsinë e disiplinës ushtarake, ndjenim të na ngrohte zemrat fjala e profesorëve tanë, të cilët na porosisnin, na këshillonin dhe na stimulonin kurajën për t’u bërë njerëz të mirë, të ditur, me norma e vlera qytetare... “Djem, do bëheni kuadro nesër,mos na turpëroni...!”. Vitet kaluan. breza të tërë oficerësh të dalë nga shkolla “Skënderbej”, e më pas



IN MEMORIAM



VLERE E MËSUESIT DHE PESHA E QIELLIT NUK MATEN KURRË!

MIRËNJOHJE PROFESOR
SKËNDER ZAIMI!

nga ajo e Lartë e Bashkuar, që shërbyen kudo nëpër Atdhe dhe që kudo ku kontribuan vunë ‘gjurmën’ e tyre të vlerë.

Si Skënderbegas, sigurisht që kemi përjetuar një arsimim të fortë akademik dhe ushtarak, ku këta profesorë kanë luajtur një rol kyç. Kujtimi i tyre tregon jo vetëm respektin që kemi ne si studentët e tyre, por edhe vlerën e mësimave akademike dhe njerëzore që ata lanë pas.

Një prej tyre është dhe profesor Skënder Zaimi, një nga emrat e nderuar të pedagogjisë së ushtrisë shqiptare, i njohur për profesionalizmin dhe përkushtimin e tij në arsim, me integritet të lartë, i cili nuk bënte kompromis me dijen dhe edukimin. Ai jo vetëm kërkonte disiplinë dhe përgatitje serioze nga studentët, por edhe tregonte një qasje njerëzore dhe prindërore ndaj tyre.

Në leksione, përveç transmetimit të njohurive akademike, ai përpiquej të frymëzonte studentët me shembuj konkretë nga jeta dhe praktika. Ishte një figurë që ngjallte respekt, jo vetëm për erudicionin e tij, por edhe për etikën e fortë që përfaqësonte.

Skënder Zaimi ka qenë profesori ynë i merceologjisë, një disiplinë që merret me studimin e mallrave, cilësinë dhe karakteristikat e tyre në raport me tregtinë dhe ekonominë. Të gjithë ne studentët e tij e kujtojmë si një njeri me një qasje të rreptë, por të drejtë ndaj disiplinës akademike. Ai ka pasur një stil mësimdhënieje rigoroz, duke kërkuar nga studentët jo vetëm njohuri teorike, por edhe një kuptim praktik të lëndës. Profesor Skënderi ishte ai i cili na bënte të na vriste ndërgjegjja, me njerëzillëkun dhe fisnikërinë e tij.

Profesorë të tillë me qasje prindërore mbeten përjetësisht në memorie, sepse përveçse japin dije, ata krijojnë një lidhje emocionale dhe ndikuese në formimin tonë si njerëz.

Profesor Skënderi nuk e shihte mësimdhënien thjesht si një punë, por si një mision për të formuar breza të ndershëm dhe të aftë. Kur dikush të mëson me zemër, është e vështirë ta harrosh.

Profesori me qasje prindërore, i cili nuk kufizohej vetëm në dhënien e njohurive akademike, por afekcioni i tij ndikonte edhe në ndërtimin e karakterit të studentëve, duke na transmetuar vlera si ndershmëria, përkushtimi dhe përgjegjësia. Profesor Skënderi shpesh sillte stile të veçanta të shpjegimit, herë me humor, rreptësi, të dashur,

apo shembuj jetësorë që e bënin mësimin më të lehtë dhe të paharrueshëm. Ai tregonte kujdes dhe sinjeritet ndaj studentëve,

Njerëz si profesor Skënderi bëhen figura që frymëzojnë dhe shërbejnë si modele për studentët edhe vite pas diplomimit.

Me mbështetjen dhe këshillat e mençura, profesori ka ndihmuar çdo student në momentet e vështira, duke mbetur të gdhendura në memorien e studentëve përjetësisht. Kujtimet tona për profesorët e dashur janë të mbushura me respekt dhe mirënjohje.

Gjatë viteve të shkollës së mesme, lidhjet ndërmjet nxënësve dhe mësuesve formohen mbi baza të forta, duke ndikuar ndjeshëm në zhvillimin personal dhe profesional të nxënësve, kjo periudhë është e mbushur me energji, përpjekje, shpresa dhe dëshira të zjarrta për t’u arsimuar e për t’u bërë dikush në jetë.

Profesorët janë udhërrëfyesit tanë në rrugën e dijes, ata që na japin jo vetëm njohuri, por edhe frymëzim për të ndërtuar të ardhmen. Kur një mësues largohet nga kjo jetë, nuk shuhet vetëm një njeri, por një dritë që ka ndriçuar mendjet dhe zemrat e shumë nxënësve. I tillë ishte dhe profesori ynë, të cilin e kujtojmë me dhimbje dhe mirënjohje, kujtojmë jo vetëm pasionin dhe përkushtimin e tij për lëndën që predikonte, por edhe vlerat e ndershmërisë e punës.

Profesor Skënder Zaimi nuk ishte thjesht një mësues, por një prind i dytë, një mik që na udhëhoqi në momentet më të rëndësishme të formimit tonë.

Kujtimet për të do të mbeten gjithmonë të freskëta. Ato orë mësimi që shpesh shkonin përtej kurrikulës, këshillat e tij të mençura dhe buzëqeshja e tij e ngrohtë do të jetojnë gjithmonë në zemrat tona.

Ai besonte tek ne studentët e tij, edhe atëherë kur ne shpesh dyshonim tek vetja jonë, dhe përpiquej të na rriste vetëbesimin, që shpesh për shkak të moshës e vinim në dyshim.

Profesor Skënderi ishte një bashkëshort dhe prind i shkëlqyer dhe kjo reflektohej dhe tek qasja e tij ndaj nesh në dimensionet e njeriut të realizuar. Largimi i tij nga jeta la dhimbje për familjen, shokët dhe miqtë e tij.

Pushofsh në paqe, profesor! Mirënjohja jonë është e përjetshme!

NATO RIPOHON ANGAZHIMIN E SAJ PËR STABILITETIN E BALLKANIT PERËNDIMOR, NDËRSA SEKRETARI I PËRGJITHSHËM RUTTE PËRFUNDON VIZITAT NË SARAJEVË DHE PRISHTINË

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ka vizituar Sarajevën dhe Prishtinën. Në Sarajevë, ai u takua me zyrtarë të nivelit të lartë nga Bosnja dhe Hercegovina, duke përfshirë Kryesuesin dhe anëtarët e Presidencës, Kryesuesin e Këshillit të Ministrave, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Mbrojtjes dhe Ministrin në detyrë të Sigurisë, si dhe me Komandantin e Shtabit të NATO-s Sarajevë, Përfaqësuesin e Lartë për Bosnjën dhe Hercegovinën, Komisionin e BE-së dhe Herzegovinës. Sekretari i Përgjithshëm u angazhua edhe me studentët në Universitetin e Sarajevës.

Gjatë vizitës së tij, z. Rutte theksoi se “NATO mbetet fuqishëm e përkushtuar ndaj stabilitetit të këtij rajoni dhe ndaj sovranitetit, integritetit territorial dhe sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës”. Ai shtoi se “Marrëveshja e Paqes së Dejtonit është gur themeli i paqes në këtë vend dhe duhet respektuar; dhe ne mbështesim Zyrën e Përfaqësuesit të Lartë. Çdo veprim që cenon Dejtonin, rendin kushtetues ose institucionet kombëtare është i papranueshëm; retorika dhe veprimet inflamatore janë të rrezikshme, ato përbëjnë një kërcënim të drejtpërdrejtë për stabilitetin dhe sigurinë e Bosnjë-Hercegovinës.” Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s nënvizoi gjithashtu nevojën që liderët politikë në Bosnje dhe Hercegovinë “të bëjnë pjesën e tyre” dhe “të marrin përgjegjësi” për përparimin dhe stabilitetin e vendit të tyre. Ai e bëri të qartë se “ky nuk është viti 1992” dhe se NATO dhe partnerët e saj ndërkombëtarë janë të pranishëm dhe të angazhuar në Bosnje dhe Hercegovinë dhe “nuk do të lejojnë të shfaqet një vakum sigurie”. Në fund, ai theksoi se Aleanca qëndron e përkushtuar në bashkëpunimin e saj me Bosnje-Hercegovinën. “Ne tashmë kemi një partneritet solid dhe jemi të përgatitur të ndërtojmë mbështetjen e gjatë të NATO-s për Forca të Armatosura të unifikuara dhe për reformat e mbrojtjes dhe sigurisë, nëpërmjet selisë sonë në Sarajevë, Celulës sonë Politike të sapokrijuar dhe Paketës sonë të Ndërtimit të Kapaciteteve Mbrojtëse”, - tha ai.

Në Prishtinë, Sekretari i Përgjithshëm udhëhoqi një vizitë të Këshillit të Atlantikut të Veriut dhe partnerëve kontribuues të trupave në misionin e KFOR-it të udhëhequr nga NATO dhe Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s. Së bashku me zëvendëssekretaren e përgjithshme të NATO-s, znj. Radmila Shekerinska dhe kryesuesin e Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiralin Giuseppe Cavo Dragone, ata u takuan me udhëheqjen dhe personelin e KFOR-it dhe Ekipin Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALT). Ata kanë shkëmbyer mendime edhe me shefat e misioneve të Bashkimit Evropian, Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe Shefin e Misionit të UNMIK-ut, si dhe Ushtresin e Detyrës së Shefit të Misionit të OSBE-së. Më tej, Sekretari i Përgjithshëm u takua me përfaqësues të institucioneve në Kosovë, për diskutime bilaterale.

“NATO ka mbështetur paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor për tridhjetë vjet. Angazhimi ynë mbetet i fortë edhe sot, i kryesuar nga KFOR-i, i cili është misioni ynë më i gjatë dhe aktualisht më i madh. Nën udhëheqjen e shkëlqyer të gjeneralmajor Enrico Barduani, trupat tona të KFOR-it punojnë pa pushim për të siguruar një mjedis të sigurt dhe të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë, në përputhje me mandatin e gjatë të KFOR-it në OKB. Ekipi Këshillues dhe Ndërlidhës i NATO-s vazhdon të mbështesë organizatat e sigurisë në Kosovë, përmes ngritjes së kapaciteteve, edukimit dhe koordinimit të trajnimit. Një rajon i sigurt i Ballkanit Perëndimor do të thotë më shumë siguri në të gjithë zonën euroatlantike”, - tha Sekretari i Përgjithshëm Rutte. “NATO do të vazhdojë të luajë rolin e saj, në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë, në rolet tona përkatëse si reagues të sigurisë”, - shtoi ai.

“Zgjidhja që çon drejt paqes afatgjatë është politike. NATO do të vazhdojë të mbështesë plotësisht normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Kjo është mënyra e vetme për të zgjidhur çështjet në pritje dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme, duke siguruar që të drejtat e të gjitha komuniteteve të respektohen dhe të mbrohen. Për të çuar përpara dialogun, të dyja palët duhet të tregojnë fleksibilitet, të bëjnë kompromiset e nevojshme dhe të fokusohen në përfitimet afatgjata”, - theksoi ai.

Presidentja Vjosa Osmani, në konferencën e mbajtur pas takimit me sekretarin e NATO-s, Mark Rutte, tha se Kosova do të vazhdojë të jetë aleat i



besueshëm kundër kërcënimeve hibride dhe ndërhyrjeve të huaja.

“Po ashtu jemi të gatshëm që të mbështesim infrastrukturën e NATO-s dhe të kontribuojmë në misionet e saj duke forcuar më tej rolin tonë si eksportuese të sigurisë”, - tha Osmani.

Presidentja Osmani vlerësoi lart kontributin e forcave paqeruajtëse të KFOR-it për lirinë e Kosovës. Ajo iu drejtua sekretarit të NATO-s, duke u shprehur se “në Kosovë do të jeni gjithmonë si në shtëpinë tuaj, e ndërtuar në liri edhe me kontributin e mijëra burrave dhe grave në uniformën e KFOR-it. Misioni ky, që mbetet më i gjati, më i madhi por edhe më i suksesshmi në historinë e NATO-s”, - deklaroi presidentja Osmani.

Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, mirëpriti Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, për herë të parë në këtë

rol. Ai e uroi për detyrën e re dhe i dëshiroi sukses në udhëheqjen e Aleancës në këtë periudhë kritike për sigurinë evropiane dhe



globale. Kryeministri Kurti shprehu mirënjohjen e tij për kontributin e çmueshëm të NATO-s në ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë. Ai theksoi se “Aspirata e Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO reflekton përkushtimin e vendit tonë ndaj vlerave të përbashkëta të demokracisë, sundimit të ligjit dhe sigurisë dhe vullnetit për të kontribuar në fuqizimin të mëtejshëm të Aleancës”. Gjithashtu, Kryeministri falënderoi Sekretarin Rutte për bashkëpunimin e ngushtë mes misionit të NATO-s, KFOR-it, dhe institucioneve të sigurisë së Kosovës, si dhe për mbështetjen e vazhdueshme të NATO-s ndaj Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës nëpërmjet misionit këshillëdhënës NALT.

Në diskutim Kryeministri ngriti shqetësimin për ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të Serbisë, me mbështetjen e Rusisë, ndaj komunitetit serb përmes presionit, shantazhit dhe dezinformimit. Ai theksoi se raportet e misionit të vëzhguesve të BE-së kanë evidentuar përhapjen e dezinformatave nga mediat ruse me bazë në Serbi, si “RT Balkans” dhe “Sputnik Srbija”, të cilat kanë shpërndarë mbi 60 artikuj që synonin manipulimin e komunitetit serb në Kosovë.

Kryeministri Kurti falënderoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës dhe qytetarëve të saj, dhe theksoi gatishmërinë e Kosovës për të qenë përherë aleate në mbrojtje të vlerave demokratike.



“POGONICA ME ÇIPINË Ç’KANË QË QAJNË ME LOT?”



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ,
(Mjeshtër i Madh)

Mblodhe gjithë shokët dhe bëre betim...

Pano Koço Xhixho lindi në katundin Suhë të Gjirokastrës në vitin 1918, në një familje patriotike. Mbaroi shkollën fillore në fshat dhe filloi punë në qytetin e Gjirokastrës. Këtu u njoh me Muzafer Asqerinë, që ndikoi në formimin e tij si antifashist. Në luftën italo-greke, Pano Xhixho u gjend i rreshtuar në formacionet shqiptare që mobilizoi ushtria fashiste. Dezertoi nga ushtria dhe u internua nga grekët në ishullin Kretë. Midis ushtarëve të internuar zhvilloi veprimtari për të mbajtur tek shqiptarët të pashuar ndjenjat patriotike. Pas lirimit nga internimi Pano mësoi zanatin e rrobaqepësit dhe punoi në Gjirokastrë. Këtu u vu tërësisht në shërbim të Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Në fillim të vitit 1942, si komandant i njësitit gueril të fshatit, mori pjesë në mjaft aksione si në Kakavijë, Libohovë etj. Pastaj kaloi në çetën e “Rinisë” dhe me vonë komisar i çetës “Prokop Meksi”. Më 25 prill 1944, me formimin e BrVIII, caktohet komisar i batalionit. Kudo u shqua për trimëri, guxim e zgjuarsi në veprime. Fitoi një respekt e besim aq të madh midis partizanëve, sa ata e konsideronin fitoren të sigurt kur kishin komisarin midis tyre. Mori pjesë në luftën për çlirim e Tiranës, BrVIII parakaloi para Qeverisë Demokratike shqiptare, më 28 nëntor 1944, dhe morën urdhër për të vazhduar luftimet drejt Shkodrës dhe në ndjekje të armikut përtej kufijve të atdheut. Në betejën për çlirimin e qytetit të Vishegradit, kur divizionet tona shkuan në ndihmë të popujve të Jugosllavisë, 14 shkurt 1945, komisarin e batalionit e shohim në radhët e para të atyre që sulmonin drejt qytetit. Por aty, në krah të shokëve partizanë, nëpërmes zjarrit dhe plumbave të armikut, Pano u plagos rëndë në kokë nga plasja e një mine dhe më pas nga këto plagë vdiq. Populli, ashtu si për gjithë bijtë e vet, veprën dhe kujtimin e Panos e përjetësoi në këngë: Bir i këtij fshati, lerë në suferinë,/ S’durove armikun, s’deshe skllavërinë,/ Mblodhe gjithë shokët dhe bëre betimin,/ Lule, Pano Xhixho, komisari trim... Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 95, datë 30. 05. 1987 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Gjirokastrës.

Dha jetën, për të drejtën, për të vërtetën

Sulejman Nazo Hysenaj ka lindur në vitin 1926. U rrit mes skamjes, por i kalitur në rrebeshin e atdhetarisë. Ishte pjesëmarrës në veprimtaritë e organizuara në terren gjatë viteve të luftës dhe, më 25 prill 1944, si luftëtar trim u radhit e BrVIII. Më 5 shkurt 1945, në një përlshje të ashpër me forcat naziste në Vishegrad, bie për të mos vdekur kurrë. Populli e ka futur në këngë: “Sulejman të kërkon brigada,/ Të bësh sulme me granata,/ O Sulejman, ti e dha jetën,/ Për të drejtën, për të vërtetën”. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tepelenës.

Pushka e Shazos jehoi dhe në Vishegrad

Shazo Habib Bushi lindi më 1918, në fshatin Salari të Tepelenës. Mbeti jetim dhe me dy vëllezërit u vendos në fshatin Erind të Lunxhërisë. Në vitin 1941 Shazon e rekrutuan ushtar. Në shkurt 1943 dezertoi nga radhët e ushtrisë dhe doli partizan në çetën “Koto Hoxhi”. U dallua për guxim dhe trimëri në luftën e Libohovës, në Grykën e Këlcyrës, në Borsh, Fterë etj. U inkuadrua në radhët e BrVIII. Në të gjitha luftimet që nga Jugu në Veri, gjer në ditën e çlirimit, më 29 nëntor 1944, u dallua si luftëtar trim dhe i vendosur, i dashur e i thjeshtë me shokët, i egër me armikun. Pushka partizane i dhuroi lirinë popullit dhe Atdheut, por lufta s’kishte mbaruar, nazizmi gjerman vazhdonte të rezistonte. Dhe pushka e Shazos jehoi edhe në Mai të Zi, Bosnje e Vishegrad. Më 5 shkurt 1945, në Vishegrad Shazo ra në luftimet e ashpra që zhvilloi me armiq të BrVIII. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 65, datë 02. 10. 1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Gjirokastrës.

Luftoi si Tafil Buzi

Shefit Barjam Durmishaj ka lindur në vitin 1908 në një familje të varfër fshatare, në Buz të Tepelenës, por të shquar për ndjenja patriotike. Më 25 prill 1944, radhitet partizan në BrVIII dhe ka marrë pjesë në të gjitha luftimet e zhvilluara prej saj. Më 25 dhjetor 1944, bie heroikisht në Malin e Zi në luftimet e zhvilluara kundër forcave gjermane. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tepelenës.



Ranë si trima në fushën e luftës Mustafa Riza Runa ka lindur në vitin 1928 në Nivicë të Kurveleshit, në një familje me ndjenja atdhetare. Mustafai në dhjetor 1943 radhitet luftëtar në Grupin e Parë Partizan të Kurveleshit dhe, më vonë, shkon luftëtar në BrVIII. Kudo e kurdoherë tregoi guxim e trimëri. Më 14 shkurt 1945, bie në Vishegrad gjatë luftimeve kundër forcave naziste. Populli këndon: “Mustafa Runa me shokë,/ Ranë nga minat në tokë”. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3. 8. 1971, të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Tepelenës.

...Tani e ka fjalën pushka

Sado Musa Meleqi ka lindur në vitin 1922, në lagjen Dunavat të Gjirokastrës. Sado shumë shpejt u lidh me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe iu kushtua veprimtarive dhe aksioneve konkrete, por aktiviteti i tij i dëndur ra në sy të armiqve. Në prill 1943 fashistët italianë e burgosën, e rrahën, e torturuan, por nuk e përkulën dot. Në tetor 1944 dërgohet me detyrë në Sarandë dhe Delvinë dhe në tetor 1944, u inkuadrua në rreshtat e BrVIII, ku u dallua për trimëri e guxim të rrallë. Pushka e tij u dëgjua në Berat, Lushnje e Tiranë. Pas çlirimit të Shqipërisë BrVIII, u nis për në Jugosllavi. Në betejën e Vishegradit ku kompania e tij kishte zënë pozicione luftimi në një faqe mali. Gjermanët rezistonin dhe nuk i lëshonin pozicionet. Duhej hapur rruga, në mënyrë që kompania të hidhej në sulm. Sadoja, me mitraloz në dorë, pa përfillur jetën, lëshohet përpara duke qëlluar pa pushim mbi gjermanët. Ai e hapi rrugën dhe kompania u hodh në sulm për asgjësimin e plotë të armikut, por në këtë kohë plumbat e një mitralozi armik e goditën Sadon në gjoks. Ai dha jetën në kodrat përballë Vishegradit. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 65, datë 02. 10. 1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Gjirokastrës.

Mbeti në ballë të sulmit partizan

Hamit Demo Pula lindi në katundin Zhulat të Gjirokastrës në vitin 1920. Në fillim të vitit 1941 Hamiti kreu shërbimin ushtarak në Fushë-Krujë. Këtu u lidh me patriotë antifashistë. Hamiti, së bashku me disa ushtarë e nënoficerë, u arratisën duke marrë me vete dhe armatimet e pajimet e tyre në korrik 1941. Hamiti u lidh me komunistët e parë të qarkut të Gjirokastrës. Mori pjesë aktive në njësitet guerile të krahinës së Kardhiqit, në ndarjen e të dhjetave të popullit të krahinës së Theollogos, Rrëzomës së Delvinës, Vurgut e tjera. Hamiti shkoi partizan në çetën “Koto Hoxhi” dhe ishte njeri i fjalës dhe i aksionit, i dashur me shokët, i ashpër dhe i heshtur në betejë, trim i vendosur dhe modest. U shqua për mendjen e mprehtë, për manovrimet e shkathëta dhe të sakta që bënte, prandaj e thërrisnin “strategu i çetës”. Disa ditë para punimeve të Kongresit të Përmetit u emërua komandant kompanie në BrVIII. Hamiti mori pjesë në luftimet që zhvilloi brigada në qarkun e Gjirokastrës, në luftën legjendare për çlirim e Tiranës e deri në Jugosllavi, kundër mbeturinave të nazizmit gjerman, ballistëve të tërhequr dhe çetnikëve jugosllavë. Në luftimet për çlirimin e qytetit të Vishegradit, që u zhvilluan më 5 shkurt 1945, Hamiti me kompaninë e tij u ndodh në ballë të zjarrit të forcave armike. Dimri ishte shumë i ashpër. Dëborë arrinte

gjer në brez. Me vendosmëri të patundur kompania e Hamitit u sul drejt pozicioneve të përparuara të armikut. Komandanti, Hamit Pula, u hodh përsëri në sulm. “Para partizanë!” thirrte ai, dhe rreshtat e armiqve u çanë. Ai mbeti aty, në ballë të sulmit partizan... Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 65, datë 02. 10. 1971 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Gjirokastrës.

Larg Atdheut

Selman Bino Leskaj lindi në vitin 1928 në Kallarat të Vlorës. Babai dhe xhaxhai i Selamit morën pjesë aktive në luftë kundër forcave shoviniste greke më 1914, të cilat dogjën e shkatërruan jugun e Shqipërisë dhe plotësisht fshatin Kallarat. Me të njëjtën trimëri e heroizëm luftuan vëllezërit Leskaj më 1920 kundër pushtuesve italianë. Rugën e të parëve të tij ndoqi djaloshi 17 vjeçar Selami, i cili u inkuadrua në BrVIII. Nëse do të ndriçonim luftime të BrVIII në Zagori, aty do të gjenim edhe gjurmën e vogëlushit Selam. Nëse do të ndaleshim në luftimet në qytetin e Gjirokastrës aty do të dëgjojmë dhe krismën e pushkës së Selamit. Nëse mësojmë për heroizma të brigadës në luftimet për çlirim e Tiranës, aty do të ndeshim edhe gjurmët e Selamit. Mandej shtegtojmë larg Atdheut, në Mal të Zi, me akullnajë, te Mali i Brskut mbuluar me borë. Ra dëshmor në qytetin Rudo, në Bosnje, më 12 janar 1945. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 97, datë 22. 09. 1972 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Vlorës.

Frymën e dha në Vishegrad

Ali Birçe Ribaj lindi në Kallarat të Vlorës, në vitin 1917, në një familje fshatare patriote. Krahina u bë djepi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare, baza e luftës. Aliu hyri në çetën vullnetare territoriale “Mumin Selani” dhe mori pjesë në aksionet luftarake të çetës. ...Në Borsh e në Himarë në Gjorm e në Mesaplik, gjithkund jehoi dyfeku i djemve të Kallaratit. Aliu e la çetën vullnetare dhe iu përgjigj thirrjes së këshillit nacionalçlirimtar të fshatit Kallarat, shkoi partizan në rreshtat e BrVIII, ku e caktuan mitraljer. Aliu së bashku me partizanët e BrVIII mori pjesë në luftimet për çlirim e Gjirokastrës, të Konispolit, të Beratit e të Tiranës. Deri në Vishegrad të Bosnjës shkeli këmba e partizanit nga Kallarat, Ali Birçe Ribaj. Deri në Vishegrad u dëgjua zëri dhe krismat e mitralozit të djaloshtit nga Kallarat. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 97, datë 22. 09. 1972 të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Vlorës.

E dha jetën tej kufijve të atdheut

Polo Vasil Qurku lindi në dhjetor të vitit 1927, në fshatin Çorraj të Sarandës. Nuk ndoqi shkollë, por që herët punoi si çirak në Vlorë. Me pushtimin e vendit nga Italia fashiste u kthye përsëri në fshat. Në fillim të 1943, u aktivizua me rininë antifashiste dhe kur kaloi në fshat BrVIII u rreshtua në radhët e saj. Mori pjesë në shumë luftime, që zhvilloi brigada, edhe në betejën për çlirim e Tiranës. ...Kishte ardhur marsi i vitit 1945. Ai marshonte në rreshtat e brigadës, ku në luftime për lirinë, e dha jetën tej kufijve të atdheut, në tokat e Jugosllavisë. Është shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 166, datë 27. 12. 1977, të Komitetit Ekzekutiv të KP të Rrethit të Sarandës.

Atdheu përjetë mirënjohës

Viti 1997 do të mbetet në memorien e shqiptarëve si një vit i tmerrshëm dhe i përgjakshëm

Marsi i vitit 1997 e të tjerë muaj në vazhdim, kur shteti u ‘çmend’ dhe futi shqiptarët në një luftë të pa kuptimtë me njëri-tjetrin, do të mbetet një nga ngjarjet më të rënda në historinë e Shqipërisë e të kombit shqiptar.

Pasojat e kësaj ‘lufte pa armik’ do të mbeten si një plagë që gjithmonë do të dhembë në ndërgjegjen kombëtare shqiptare, edhe për faktin se arkitektët e saj, jo vetëm që nuk dhanë llogari për atë që bënë, por në një formë apo një tjetër u ricikluan dhe shtuan pasuritë e babëzisë me gjakun, djersën, mundin dhe pronat e shqiptarëve të ndershëm. Marsi i atij viti është plagë e hapur për sa kohë kryefajtorët nuk janë ndëshkuar! Gjithsesi, ne kujtojmë, nderojmë e respektojmë dy oficerët e mrekullueshëm të Mbrojtjes Kundërajrore: Kapiten Muhamet Hasmuja dhe toger Arben Hoxha, efektivë të Divizionit të Shkodrës, më 12 mars 1997, për të mbrojtur repartin, për të shpëtuar jetën e efektivit, i qëndruan besnik betimit para flamurit kombëtar e flamurit luftarak të njësisë, ecën drejt pavdekësisë, dhanë jetën në krye të detyrës.

Vepra sublime e këtyre oficerëve, “Dëshmorë të Atdheut”, nuk mund të harrohet kurrë! Të gjallët, i detyrohen shumë kujtimit, nderimit dhe sakrificës së tyre. Këto rreshta janë njëherazi thirrje për kujtesë, memorie, vëmendje, përkujdesje të shtetit ndaj familjeve e fëmijëve të dëshmorëve tanë.

Mijëra të rinj humbën jetën pasi popullsia ishte e armatosur për shkak të hapjes së depove të armatimit. Shkodra, mbetet një prej qyteteve me bilancet më të rënda nga kjo ‘luftë civile’, por falë sakrificave të disa oficerëve të policisë dhe ushtrisë, situata nuk u përkeqësua edhe më tej, pasi populli mund të pajisej me granata apo raketa.

Të gjithë shkodranët mbajnë mend mbrëmjen e 12 marsit të vitit 1997, ditën kur qindra qytetarë, u nisën drejt repartit ushtarak dhe baterisë kundërajrore që ndodhej në Dobraq, për të marrë armë. Atë mbrëmje të hidhur ranë dëshmorë të atdheut edhe 2 oficerët e ushtrisë, Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxha.

Muhamet Hasmuja, asokohe ishte 38 vjeç, me gradën kapiten i parë, ishte emëruar komandant i bazës, ndërsa Arben Hoxha nga Elbasani ishte toger, oficer i këtij reparti.

Kolegë të tyre kujtojnë ditën e 12 marsit, kur po shërbenin dy oficerët. “Rreth orës 12:00, pasi u inspektua baza kundërajrore në Dobraq, për t’u njohur me masat që oficerët kishin marrë për mbrojtje, pasi ishte situatë problematike. Muhameti si drejtues kishte marrë masa shumë të mira dhe gjithçka ishte e organizuar ashtu siç e kërkonte protokolli.

Orët e mbrëmjes së 12 Marsit, u shoqëruan me sulmin e turmave ndaj reparteve ushtarake të Shkodrës. Rreth orës 19.30 minuta, ra Divizioni Ushtarak i Shkodrës, ku ishte e gjithë komanda e veriut. Urdhri ishte i qartë për drejtuesit e reparteve të tjera, që askush të mos përdorte armët, por të mbronin depot, zyrat dhe të gjitha godinat e ushtrisë. Pak orë më vonë, sulmi vazhdoi drejt Dobraqit, aty ku ishte bateria kundërajrore.

Kur turmat mbërritën tek reparti, ata tentuan të thyejnë barrierat dhe të futen. Ushtarët dhe oficerët ishin në njërin krah me armë në duar, por pa urdhër për të qëlluar dhe në tjetrin krah turmat, ku mes tyre ishin edhe të armatosur. Në këtë situatë, Muhameti vendosi të futej në mes të turmës dhe oficerëve të tij për të shmangur përplasjet, pasi ushtarët ishin nën presion.

“Ai po u bënte thirrje qytetarëve që të largohen dhe situata të qetësohej. Në një moment, ai u rrëzua. Një dorë e zezë, nga turma qëllloi me armë drejt tij. Komandanti nuk u dëgjua më dhe u dha alarmi se Muhameti është qëlluar. Drejt tij u nisën oficerët Arben Hoxha dhe Agron Kodra për ta ndihmuar, por është dëgjuar një tjetër breshëri zjarri dhe të dy u rrëzuan”, tregon ish-shefi i shtabit të regjimentit kundërajror, Ndue Marku.

Arben Hoxha, oficeri nga Elbasani, humbi jetën menjëherë ndërsa oficeri tjetër Agron Kodra, u qëllua me 7 plumba, por për fatin e tij të mirë shpëtoi. Duke parë agravimin e situatës, ushtarët u detyruan që të qëllonin në ajër dhe të mbroheshin nga plumbat e turmave. Shkëmbimi i zjarrit ka vijuar deri rreth orës 3 të mëngjesit të 13 marsit, kur turmat janë tërhequr.

Me një kamion, trupat e tyre janë transportuar për në spitalin e Shkodrës, ku janë njoftuar edhe familjarët. Arben Hoxha, u dërgua më pas në Elbasan tek familjarët e tij.



Por çfarë pasojash do të kishte për Shkodrën dhe Shqipërinë, nëse reparti kundërajror nuk do të mbrohej deri në fund dhe do të ishte në duart e turmave?

“Pasoja fatale! Fatkeqësi të jashtëzakonshme. Kemi të bëjmë me topa kundërajror, raketa në gatishmëri për zjarr dhe tritol. Një pakujdesi sado e vogël, madje edhe një cigare, do të shkaktonte shpërthimin e tyre, pa llogaritur më pas nëse dikush do të

aktivizonte topat apo raketat. Pasojat do të ishin fatale për mijëra njerëz”, shpjegojnë ekspertët,

Në vitin 1998, Muhamet Hasmuja dhe Arben Hoxhën, Këshilli i Qarkut të Shkodrës i shpalli “Dëshmorë të Atdheut”. Në nderim të tyre u ngrit edhe një obelisk tek ish-regjimenti kundërajror në Tepe.

Akti i tyre është dhe do të mbetet burim frymëzimi!

“

PASOJAT E KËSAJ ‘LUFTE PA ARMIK’ DO TË MBETEN SI NJË PLAGË QË GJITHMONË DO TË DHEMBË NË NDËRGJEGJEN KOMBËTARE SHQIPTARE, EDHE PËR FAKTIN SE ARKITEKTËT E SAJ, JO VETËM QË NUK DHANË LLOGARI PËR ATË QË BËNË, POR NË NJË FORMË APO NJË TJETËR U RICIKLUAN DHE SHTUAN PASURITË E BABËZISË ME GJAKUN, DJERSËN, MUNDIN DHE PRONAT E SHQIPTARËVE TË NDERSHËM.

“

“

KOLEGË TË TYRE KUJTOJNË DITËN E 12 MARSIT, KUR PO SHËRMBENIN DY OFICERËT. “RRETH ORËS 12:00, PASI U INSPEKTUA BAZA KUNDËRAJRORE NË DOBRAÇ, PËR T’U NJOHUR ME MASAT QË OFICERËT KISHIN MARRË PËR MBROJTJE, PASI ISHTE SITUATË PROBLEMATIKE. MUHAMETI SI DREJTUES KISHTE MARRË MASA SHUMË TË MIRA DHE GJITHÇKA ISHTE E ORGANIZUAR ASHTU SIÇ E KËRKONTE PROTOKOLLI.

“

Vendet evropiane me ushtritë më të forta

Fuqia ushtarake e Evropës ka marrë një urgjencë të re në mes të luftës së vazhdueshme midis Rusisë dhe Ukrainës. Komisioni Evropian ka propozuar mobilizimin e deri në 800 miliardë euro (863 miliardë dollarë) për mbrojtjen, ndërsa tensionet me BE-në rriten për veprimet e Rusisë. Që kur Presidenti Donald Trump mori detyrën përsëri në janar, SHBA ka pasur një marrëdhënie komplekse me aleatët evropianë në lidhje me Rusinë dhe Ukrainën, duke nxitur ndarje të mëtejshme. Kjo galeri shikon vendet evropiane me ushtritë më të forta, duke theksuar gatishmërinë e tyre për të lundruar në këto sfida gjeopolitike në rritje.



10. PORTUGALIA

Portugalia luan një rol vendimtar në iniciativat mbrojtëse të NATO-s, me një prani të dukshme detare. Vendi i vogël ka rreth 24,000 personel aktiv ushtarak, 117 avionë ushtarakë, 11,173 automjete ushtarake dhe 113 anije dhe nëndetëse të marinës.



9. GREQIA

Greqia ka një prani të fortë ushtarake, me fokus në mbrojtjen detare për shkak të vendndodhjes së saj strategjike në Mesdhe. Ajo ka afërsisht 142,700 personel aktiv, 632 avionë, 57,030 automjete dhe 187 anije detare.



8. SUECIA

Suedia, e cila u bashkua me NATO-n në vitin 2024, mban një ushtri të fortë me 24,400 personel aktiv, 212 avionë, 7,958 automjete ushtarake dhe 353 anije dhe nëndetëse të marinës.



7. POLONIA

Polonia ka një histori të gjatë ushtarake, me një rol të rëndësishëm në Luftën e Dytë Botërore. Sot, Polonia krenohet me 202,100 personel ushtarak aktiv, 468 avionë, 13,956 automjete ushtarake dhe 45 anije dhe nëndetëse të marinës.



6. SPANJA

Spanja ka rreth 133,282 personel aktiv, 513 avionë, 15,046 automjete dhe 168 anije detare. Si një aleate e NATO-s, Spanja luan një rol vendimtar në sigurinë evropiane dhe globale, me një prani të fortë ushtarake historike.



5. GJERMANIA

Si një anëtare e NATO-s, Gjermania luan një rol jetik në mbrojtjen evropiane. Ajo ka rreth 181,600 personel aktiv ushtarak, 618 avionë, 79,317 automjete dhe 64 anije të marinës.



4. UKRAINA

Në mes të luftës së vazhdueshme me Rusinë, ushtria e Ukrainës ka pësuar një modernizim dhe zgjerim të konsiderueshëm për të mbrojtur sovranitetin e saj. Ajo ka rreth 900,000 personel aktiv ushtarak, 321 avionë, 22,110 automjete dhe 104 anije të marinës.



3. FRANCA

Franca ka 200,000 personel aktiv ushtarak, 972 avionë, 85,023 automjete dhe 128 anije të marinës. Si një fuqi bërthamore, ajo mbetet një lojtar kyç në mbrojtjen globale, veçanërisht në mes të tensioneve gjeopolitike evropiane.



2. ITALIA

Italia ka 165.500 personel ushtarak aktiv, 800 avionë, 61.892 automjete ushtarake dhe 309 anije të marinës. Me një histori të pasur ushtarake, Italia luan një rol kyç në NATO dhe misionet paqeruajtëse globale.



1. MBRETËRIA E BASHKUAR

Mbretëria e Bashkuar krenohet me rreth 184,860 personel ushtarak aktiv, 664 avionë ushtarakë, 27,203 automjete ushtarake dhe 117 anije dhe nëndetëse të marinës. Një anëtare e madhe e NATO-s, Britania e Madhe ka një histori të gjatë ndikimi ushtarak global, veçanërisht gjatë dy Luftërave Botërore.

Epoka e teknologjisë: Privatësia e të dhënave në rrezik!

Në shekullin e 21-të, ne jemi dëshmitarë të një revolucioni dixhital të paprecedentë që ka transformuar mënyrën se si jetojmë, punojmë dhe komunikojmë. Nga platformat e mediave sociale dhe ruajtja në rene kompjuterike te pajisjet inteligjente dhe intelijenca artificiale, teknologjia prek çdo aspekt të jetës moderne. Megjithatë, me këtë lidhje të pamasë vjen një sfidë kritike: sigurimi i privatësisë së të dhënave personale në një epokë ku informacioni është monedhë. Privatësia e të dhënave nuk është thjesht një çështje teknike; është një imperativ shoqëror që kërkon vëmendje të menjëhershme.

Ngritja e të dhënave të mëdha

Një nga zhvillimet më të habitshme të epokës së teknologjisë është shfaqja e të dhënave të mëdha. Kompanitë dhe organizatat mbledhin, ruajnë dhe analizojnë sasi të mëdha informacioni personal, duke filluar nga zakonet e blerjeve dhe të dhënat mjekësore deri te historiku i vendndodhjes dhe shfletimit. Ndërsa këto grupe të dhënash fuqizojnë inovacione të tilla si shërbimet e personalizuar dhe analitika parashikuese, ato gjithashtu i ekspozojnë individët ndaj rreziqeve të tilla si vjedhja e identitetit, mbikëqyrja dhe shkëmbimi i paautorizuar i të dhënave.

Monetarizimi i të dhënave ka krijuar një ekosistem fitimprurës, duke çuar në shqetësime nëse korporatat i japin përparësi fitimeve mbi privatësinë e njerëzve. Lindin pyetjet: Kush i zotëron të dhënat? Si po përdoret? Dhe më e rëndësishmja, si mund të rifitojnë individët kontrollin mbi informacionin e tyre personal?

Rregulloret dhe politikat globale të privatësisë

Në përgjigje të shqetësimeve në rritje, qeveritë dhe institucionet në mbarë botën kanë zbatuar rregullore që synojnë mbrojtjen e privatësisë së të dhënave. Shembujt kryesorë përfshijnë: Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (GDPR) - E zbatuar në Bashkimin Evropian, GDPR është një nga ligjet më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të dhënave, që u jep individëve kontroll më të madh mbi të dhënat e tyre personale dhe vendos dënime të rrepta për shkelësit; Akti i Privatësisë së Konsumatorit të Kalifornisë (CCPA) - Kjo rregullore e SHBA-së u jep banorëve të Kalifornisë të drejta për të ditur, fshirë dhe të zgjedhin nga shitja e të dhënave të tyre personale; Faturat e mbrojtjes së të dhënave në të gjithë globin - Vende të tilla si Japonia, Brazili dhe India kanë prezantuar korniza të ngjashme për të mbrojtur privatësinë.

Megjithëse këto politika përfaqësojnë progres, sfidat e zbatimit dhe natyra globale e ndërveprimeve dixhitale nënvizojnë nevojën për standarde ndërkombëtare më kohezive.

Roli i teknologjisë në ruajtjen e privatësisë

Ironikisht, vetë teknologjia ofron zgjidhje për krizën e privatësisë. Përparimet në enkriptimin, blockchain dhe privatësinë diferenciale ofrojnë mjete për të mbrojtur informacionin e ndjeshëm. Për shembull, kriptimi i siguron që të dhënat të mbeten të palexueshme për palët e paautorizuara.

Teknologjia Blockchain prezanton sisteme të decentralizuara që rrisin sigurinë e të dhënave. Privatësia diferenciale mundëson analizën e grupeve të të dhënave pa zbuluar identitete individuale.

Megjithatë, miratimi i këtyre zgjidhjeve kërkon një përpjekje bashkëpunuese midis kompanive të teknologjisë, politikëbërësve dhe përdoruesve.

Implikimet Etike

Përtej rregulloreve dhe masave teknike, çështja e privatësisë së të dhënave ngre pyetje të thella etike. Ekuilibri midis inovacionit dhe privatësisë është delikat. Ndërsa teknologjitë e drejtuara nga të dhënat premtojnë përfitime shoqërore, të tilla si përmirësimi i kujdesit shëndetësor dhe planifikimi urban efikas, ato nuk duhet të vijnë në kurriz të të drejtave themelore.

Për më tepër, konsideratat etike shtrihen në përdorimin e të dhënave nga intelijenca artificiale. Sistemet e AI-së të trajnuar mbi grupe të dhënash të njëanshme ose me burim të pahijshëm mund të përjetësojnë diskriminimin dhe dezinformimin, duke nënvizuar rëndësinë e praktikave transparente dhe të drejta të të dhënave.

Fuqizimi i Individëve

Në fund të fundit, fuqia për të mbrojtur privatësinë u takon individëve. Fushatat e ndërgjegjësimit të publikut, programet e shkrim-leximit dixhital dhe cilësimet miqësore të privatësisë mund t'i fuqizojnë njerëzit të bëjnë zgjedhje të informuara për ndërveprimet e tyre në internet. Praktika të thjeshta si përdorimi i fjalëkalimeve të forta, aktivizimi i vërtetimit me dy faktorë dhe shqyrtimi i lejeve të aplikacioneve mund të rrisin ndjeshëm sigurinë e të dhënave personale.

Epoka e teknologjisë paraqet mundësi të jashtëzakonshme dhe sfida të rëndësishme për privatësinë e të dhënave. Ndërsa vazhdojmë të përqafojmë inovacionin dixhital, është e domosdoshme t'i jepet përparësi mbrojtjes së informacionit personal. Qeveritë, korporatat dhe individët duhet të punojnë së bashku për të krijuar një të ardhme ku teknologjia i shërben njerëzimit pa cenuar dinjitetin dhe autonominë e tij. Vetëm atëherë mund të kuptojmë plotësisht potencialin e epokës dixhitale duke ruajtur thelbin e asaj që do të thotë të jesh



privat në një botë të ndërlidhur.

Shembuj të botës reale të shkeljes së të dhënave

Yahoo (2013): Kjo mbetet një nga shkeljet më të mëdha të të dhënave në histori, duke prekur rreth 3 miliardë llogari. Hakerët arritën në informacionin e llogarisë, duke përfshirë pyetjet dhe përgjigjet e sigurisë, megjithëse të dhënat e kartës së pagesës dhe bankave nuk u vodhën.

Target (2013): Një sulm phishing ndaj një shitësi të palëve të treta çoi në një shkelje që komprometoi mbi 40 milionë llogari të kartave të kreditit dhe debitit. Ky incident theksoi rreziqet që lidhen me aksesin e palëve të treta.

Equifax (2017): Një dështim për të rregulluar një cenueshmëri të njohur rezultoi në ekspozimin e informacionit personal për rreth 147 milionë individë. Kjo shkelje theksoi rëndësinë e përditësimeve në kohë të softuerit.

Marriott International (2018): Hakerët fituan akses të paautorizuar në bazën e të dhënave të rezervimit të mysafirëve të Starwood, duke kompromentuar informacionin personal të rreth 500 milionë klientëve. Shkelja mbeti e pazbuluar për katër vjet.

Aadhaar (2018): Baza e të dhënave Aadhaar e qeverisë indiane, që përmban informacione të ndjeshme biometrike dhe personale të mbi 1 miliard qytetarëve, thuhet se u ekspozua për shkak të dobësive të sigurisë.

Këta shembuj nënvizojnë nevojën kritike për masa të fuqishme të sigurisë kibernetike dhe strategji proaktive për mbrojtjen e të dhënave. Më tregoni nëse dëshironi të eksploroni ndonjë nga këto raste në më shumë detaje!

Pasojat kryesore të shkeljeve të të dhënave

Yahoo (2013)

Ndikimi financiar: Yahoo u përball me një zgjidhje gjyqësore prej 117.5 milionë dollarësh dhe një gjobë prej 35 milionë dollarësh nga Komisioni i Letrave me Vlerë dhe Shkëmbim i SHBA.

Dëmtimi i reputacionit: Shkelja shkatërroi besimin në shërbimet e Yahoo dhe komplikoi blerjen e saj nga Verizon, gjë që uli çmimin e blerjes me 350 milionë dollarë.

Shqyrtimi ligjor: Yahoo u kritikua për zbulimin e vonuar të shkeljes, duke çuar në seanca dëgjimore në Kongres.

Target (2013)

Humbjet financiare: Kostot e shkaktuara prej rreth 162 milion dollarë, duke përfshirë tarifatat ligjore dhe shlyerjet.

Dëmi i reputacionit: Shkelja çoi në uljen e shitjeve të pushimeve dhe dëmtim afatgjatë të besimit të konsumatorëve.

Zgjidhjet ligjore: Target ra dakord për një marrëveshje prej 18.5 milionë dollarësh me 47 shtete dhe Distriktin e Kolumbisë.

Equifax (2017)

Ndikimi i konsumatorit: Shkelja ekspozoi informacione të ndjeshme të 147 milionë individëve, duke çuar në shqetësime të përhapura për vjedhjen e identitetit.

Pasojat ligjore dhe financiare: Equifax ra dakord për një zgjidhje deri në 700 milionë dollarë, duke përfshirë kompensimin për konsumatorët e prekur.

Dëmtimi i reputacionit: Shkelja theksoi dështimin e Equifax për të korrigjuar dobësitë e njohura, duke dëmtuar besueshmërinë e tij.

Marriott International (2018)

Gjobat rregullatore: Marriott u përball me një gjobë prej 23.8 milion dollarë sipas GDPR për dështimin në mbrojtjen e të dhënave të klientit.

Dëmtimi i reputacionit: Shkelja, e cila ekspozoi të dhënat e deri në 500 milionë të ftuar, ngriti shqetësime për sigurinë e sistemeve të saj.

Kostot operacionale: Marriott duhej të investonte shumë në përmirësimet e sigurisë kibernetike.

Aadhaar (2018)

Shqetësimet e privatësisë: Shkelja ekspozoi informacione të ndjeshme biometrike dhe personale të mbi 1 miliard qytetarëve indianë, duke çuar në frikën e vjedhjes së identitetit.

Zemërimi publik: Incidenti intensifikoi debatet në lidhje me ligjet e privatësisë së të dhënave në Indi dhe sigurinë e bazave të të dhënave të qeverisë.

Ndryshimet e politikave: Kjo nxiti thirrje për rregulla më të rrepta për mbrojtjen e të dhënave.

Këto shkelje nënvizojnë nevojën kritike për masa të fuqishme të sigurisë kibernetike dhe strategji proaktive për mbrojtjen e të dhënave.

Shkeljet e të dhënave kanë ndikuar ndjeshëm në evoluimin e ligjeve për mbrojtjen e të dhënave në mbarë botën. Këtu janë disa ndikime kryesore:

Rregullore më të rrepta: Shkeljet e profilit të lartë i kanë shtyrë qeveritë të prezantojnë ligje gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të dhënave. Për shembull, Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) në Bashkimin Evropian u zbatua për të adresuar shqetësimet e privatësisë dhe për të vendosur dënime të rrepta për mospërputhje.

Përgjegjshmëri e rritur: Ligjet si Akti i Privatësisë së Konsumatorit në Kaliforni (CCPA) në SHBA tani i mbajnë kompanitë përgjegjëse për mbrojtjen e të dhënave të konsumatorëve. Organizatat duhet të zbulojnë shkeljet menjëherë dhe të përballen me pasojat ligjore për neglizhencën.

Harmonizimi global: Shkeljet e të dhënave kanë nxjerrë në pah nevojën për bashkëpunim ndërkombëtar. Vende si Brazili (LGPD) dhe India (ligjet e propozuara për mbrojtjen e të dhënave) kanë miratuar korniza të frymëzuara nga GDPR.

Të drejtat e konsumatorit: Shkeljet i kanë fuqizuar individët me të drejta për të hyrë, fshirë ose kufizuar përdorimin e të dhënave të tyre. Ky ndryshim siguron transparencë dhe kontroll më të madh për përdoruesit.

Investimet e korporatave: Kompanitë po investojnë shumë në sigurinë kibernetike dhe pajtueshmërinë për të shmangur shkeljet dhe ndëshkimet. Kjo ka çuar në adoptimin e teknologjive të avancuara si kriptimi dhe zbulimi i kërcënimeve të drejtuara nga AI.


Këto ndryshime pasqyrojnë një njohje në rritje të rëndësisë së ruajtjes së të dhënave personale në një botë të ndërlidhur.

Në një epokë ku teknologjia na lidh të gjithëve, ruajtja e privatësisë së të dhënave nuk është thjesht një domosdoshmëri - është një detyrim për të mbrojtur thelbin e identiteteve tona dixhitale dhe jo vetëm...



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E MBROJTJES

Qendra e Personel Rekrutimit



do të rekrutojë kandidatë për studime në

**AKADEMINË USHTARAKE MODENA, ITALI,
1 (NJË) KUOTË, DEGA “GJITHARMËSH”**

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së

Personel Rekrutimit është deri më **11 prill 2025**

Për më shumë informacion kliko në linkun:

<https://www.mod.gov.al/rekrutime>

Bëhupjesë
Forcat e Armatosura
Karrierë Ushtarake
FASHqiptare